

VEZHGIM MBI POTENCIALIN E TURIZMIT DHE EKOTURIZMIT
NE ZONEN E MBROJTUR DETARE BREGDETARE
KARABURUN – SAZAN



UNDP
No: ALB-069-2012

Genc Metohu, konsulent vendas
Mars 2013

TABELA E PERMBAJTJES	1
PARATHENIE	2
Termat e Referencës së Detyrës.....	2
Background i detyrës.....	2
Statusi i Mbrojtjes së Natyrës në Zonë.....	2
1. TREGU TURISTIK	3
1.1 Rëndësia e Turizmit Ndërkombëtar.....	3
1.2 Panorama e Turizmit.....	3
1.2.1 Përcaktuesit e Kërkesës.....	3
1.2.2 Tendencat e Konsumatorëve.....	4
1.3 Tregu Turistik.....	4
1.3.1 Turizmi Masiv.....	4
1.3.2 Turizmi Natyror	5
1.3.3 Turizmi Kulturor.	7
1.3.4 Turizmi Rural.....	8
2 ZONAT E MBROJTURA DHE AKTIVITETET QE LIDHEN ME TURIZMIN	10
2.1 Kategoritë Menaxhuese të Zonave të Mbrojtura të IUCN.....	10
2.2 Aplikimi i Kategorisë II (Park Kombëtar) në zonat e mbrojtura detare	10
2.3 Pajtueshmëria e formave të turizmit në zonat e mbrojtura.	12
3. MENAXHIMI I TURIZMIT NE ZONAT E MBROJTURA	14
3.1 Ndikimet mjedisore të aktiviteteve të turizmit	14
3.2 Infrastruktura turistike në zonat e mbrojtura	15
3.3 Mekanizmat financiarë në zonat e mbrojtura	16
3.3.1 Modelet Financues	17
3.3.2 Mekanizmat e Gjenerimit të të Ardhurave për Zonat e Mbrojtura.....	18
3.3.3 Kostot dhe përfitimet për zonat e mbrojtura	21
3.3.4 Pjesmarrja Vendore dhe Zona e Mbrojtur	22
3.3.5 Local Participation in Orikumi area	24
4. STRUKTURA INSTITUCIONALE E TURIZMIT	25
4.1 Institucionet që influencojnë turizmin në nivel qendror	25
4.1.1 Struktura Administrative e Turizmit	25
4.1.2 Aktorë të tjerë	26
4.2 Politika Kombëtare e Turizmit dhe Parqet Kombëtare	27
4.3 Konteksti Lokal i Zhvillimit të Turizmit	27
4.3.1 Funksioni i Turizmit në nivel lokal	27
4.3.2 Planifikimi i Territorit	28
5. TRAINIMI I STAFIT, OPERATOREVE DHE SIPERMARRESVE	30
5.1 Shkollimi i Rregullt në Subjektet e Turizmit	30
5.1.1 Shkollimi i Nivelit Universitar	30
5.1.2 Shkollimi Profesional	30
5.2 Trainimi për Turizmin me Bazë Komunitetin	30
5.2.1 Transferimi i Dijeve.....	31
5.3 Nivelet Ideale të Kompetencës për Ofruesit e Shërbimeve të Lidhura me Turizmin	31
6. MARRDHENIA E TURIZMIT ME CMPA KARABURUN – SAZAN	35
6.1 Zonat e mbrojtura përgjatë zonës bregdetare	35
6.2 Konteksti i tanishëm i Zonës së Mbrojtur Karaburun - Sazan	37
6.3 Aktivitete të Rëndësishme Ekonomike.....	38
6.4 Konteksti i Potencialit Turistik në gjirin e Orikumit dhe të Vlorës	38
6.5 Zhvillimi Urban dhe Turistik.....	43
6.6 Konfliktet e mundshme me aktivitetet e tashme	43
6.7 Aktivitetet / produktet e mundshme ekoturistike në konsideratë në ZM.....	44
6.8 Aktivitetet e Pushimit dhe Turistike brënda ZM	45
6.8.1 Aktivitetet në Zonat Natyrore të Pushimit	45
6.8.2 Aktivitetet në Zonat Aktive të Pushimit	46
6.8.3 Fasilitetet kryesore në ZM	47
6.9 Aktivitete të Veçanta Rekreative dhe Turistike – Projekt Drejtime	48
6.10 Rekomandime për Planin e Menaxhimit	52
Aneksi 1	55
7. BIBLIOGRAFI	57

Parathënie

Termet e Referencës së Detyrës

Objektivi i përgjithshëm për detyrën brënda Tërmave të Referencës së detyrës është i dhënë si:

..... për të ofruar asistencë përsa i përket burimeve të ekoturizmit, drejtimeve, sfidave dhe sinergjive të mundshme të cilat kontribuojnë në përmirësimin e paraqitjes bio-gjeografike dhe mekanizmit eficient të menaxhimit për Zonën e Mbrojtur Detare Bregdetare, gjithashtu të strukturojë aktivitetet e tanishme dhe ato të mundshme që lidhen me turizmin dhe ekoturizmin, duke influencuar fizibilitetin e konsolidimit të ekoturizmit me bazë komunitetin me rekomandimet dhe përmirësimet.

Background i Detyrës

Zona e Mbrojtur Detare Bregdetare Karaburun – Sazan, është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.289, datë 28.4.2010 me një sipërfaqe totale prej 12 570.82 ha, e përbërë nga zona detare e Karaburunit prej 9848.95 ha dhe zona detare e Sazanit prej 2721.87 ha.

Me zhvillimin e ri urban të zonës së qytetit të Orikumit bazuar në planin rregullator urbanistik dhe zhvillimet e strukturave turistike përgjatë bregdetit të Rradhimës dhe Orikumit, presioni mbi zonën e mbrojtur po të rritet. Presionet, në të dy zonat e mbrojtura, detare dhe atë tokësore, vijnë kyesisht nga ndërtimet pa leje, zjarret në pyje, peshkimi i paligjshëm, zhytjet në det të pakontrolluara, aktivitete rekreacioni të pakontrolluara. Presioni në zonën detare deri tani nuk ka qenë aq kritik për shkak edhe të moratoriumit të detit. Ky moratorium ka qenë në fuqi për shtatë vite qysh nga data 3.04.2006 me qëllimin e luftimit ndaj trafikeve ilegale. Në këtë moment afati i moratoriumit në fuqi ka skaduar. Ndërkohë, qeveria nuk ka kërkuar një ripërtëritje të tretë të moratoriumit për t'a votuar në parlament. Ndërsa presioni në zonën tokësore, kryesisht të Gadishullit të Karaburunit, ka qenë më shumë i lidhur me zjarret e përvitshëm në periudhën e verës të vënë nga barinjët e zonës që djegin barin në shpatet e malit dhe shkaktojnë dhe djegjen e pyllit, sesa nga zhvillimet e pakontrolluara për shkak të ndalimit të hyrjes në zonë nga baza ushtarake e në Gjirin e Orikumit.

Statusi i Mbrojtjes së Natyrës në zonë

Duke ju referuar gjendjes aktuale të statusit mbrojtës të zonës, situata është si më poshtë:

- Zona e Mbrojtur Detare Bregdetare Karaburun – Sazan (Kat. II sipas kategorizimit të zonave të mbrojtura të IUCN-së);
- Rezervat Natyror i Menaxhuar Rrëza e Kanalit – gadishulli i Karaburunit (Kat. IV sipas kategorizimit të zonave të mbrojtura të IUCN-së);
- Parku Kombëtar i Llogarasë (Kat. II sipas kategorizimit të zonave të mbrojtura të IUCN-së);
- Gjithashtu, ka një numër monumentesh natyrore dhe kulturore me status ligjor mbënda kësaj zone.

1. TREGU TURISTIK

Turizmi paraqet një potencial të madh, që nëse planifikohet dhe menaxhohet siç duhet mund të ketë një ndikim minimal në mjedisin tokësor dhe detar, ndërsa gjeneron të ardhura për komunitetet që jetojnë aty përreth; meqenëse dhe një numër më i madh i turistësh tani kërkon eksperiencë edukuese në mjediset natyrore.

1.1 Rëndësia e Turizmit Ndërkombëtar

Turizmi është një nga industritë me rritjen më të shpejtë dhe më të madhe në botë. Sipas Organizatës Botërore të Turizmit (UNWTO), mbërritjet e turistëve ndërkombëtarë kanë treguar pothuajse rritje të pandërprerë – nga 277 milion në vitin 1980 në 940 milion në 2010 dhe për të arritur 983 milion në 2011¹ në mbarë botën. Rritja e turizmit në disa nga vendet më pak të zhvilluara është shumë më e madhe sesa mesatarja e përbotshme dhe turizmi është një mekanizëm tejet i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik për shumë vende në zhvillim. Ai kërkon shpenzime kapitale më të ulta për vend pune të krijuar sesa industritë e tjera dhe gjeneron punësim veçanërisht për grate dhe të rinjtë si dhe ofron mundësi për sipërmarrje dhe zhvillim të bizneseve të vegjël.

Sipas Këshillit Botëror të Turizmit (WTTC), turizmi dhe aktivitetet që lidhen vlerësohen të gjenerojnë tek 9.6% të Prodhimit Bruto (GDP), ndërsa sektori i turizmit është punëdhënësi më i madh duke numëruar tek 225 milion vende pune ose 10.7% të fuqisë puntore botërore (WTTCÇ 2008). Faturimi i turizmit ndërkombëtar për vitin 2011 vlerësohen në 1,030 miliardë US\$ në mbarë botën, nga 928 miliardë US\$ në 2010 (+3.9% në terma realë), duke vendosur rekorde të reja në shumicën e destinacioneve pavarësisht sfidave ekonomike në tregjet gjeneruese. Përfitimet e turizmit, kryesisht ekonomike, kanë qenë tejet të mëdha veçanërisht për vendet në zhvillim dhe ato të varfëra të cilat kanë burime financiare të kufizuara. Në të njëjtën kohë, pavarësisht, turizmi gjithashtu ka ndikime negative. Në veçanti, turizmi tenton të zhvillohet në disa nga mjediset më të brishta në botë – në rajonet bregdetare dhe malore – dhe nëse nuk menaxhohet siç duhet kërcënon veçanërisht burimet që tërheqin turistët së pari, gjithashtu duke shkaktuar dëme në aftësinë e këtyre rajoneve për të ofruar shërbime mjedisore.

1.2 Panorama e Turizmit

1.2.1 Përcaktuesit e Kërkesës

Përcaktuesit kryesorë të turizmit janë:

- ⇒ Demografik – tendenca e popullsisë në tregjet kryesore gjeneruese dhe ilustrimi i këtij pozicioni. Në tregjet ndërkombëtare, popullsia e moshuar e në shumicën e tregjeve kryesore gjenerues po bëhet dominuese në kërkesën turistike dhe përfaqëson një segment në rritje të popullsisë udhëtuese, deri në 2050 Kombet e Bashkuara parashikojnë që 22.1% e popullsisë botërore do të jetë mbi 60 vjeç dhe deri në mes të shekullit shumë vende të industrializuara do të kenë një moshë mesatare 50 vjeç ose më lart. Individët e moshuar kanë më shumë kohë të lire dhe të ardhura të disponueshme dhe tentojnë të jenë më shumë të interesuar në mundësitë rekreative të zonave të mbrojtura². Në tregun vendas, siç jepet në 1 janar 2013, 20% e popullsisë ishte ndërmjet 0 dhe 14 vjeç³, efektet janë se do të kërkohet një numër në rritje i mundësive për sporte aktive dhe rekreacion për të plotësuar kërkesat në rritje në të ardhmen e afërt ndërsa ky grup demografik rritet.
- ⇒ E ardhura – niveli i të ardhurës së mundshme për kokë në zonat e tregjeve. Rritja e Produktit Bruto Kombëtar (GNP) në tregjet kryesore të origjinës (vendas dhe ndërkombëtar) ka siguruar të ardhurën e mundëshme që ka mbështetur rritjen në vite.

¹ UNWTO (2011b) *Tourism Towards 2030*. Madrid.

² World Commission on Protected Areas (2002) *Sustainable Tourism in Protected Areas* Cambridge IUCN

³ Instituti Statistikës (2013) Popullsia 1 janar 2001-2013 sipas grupmoshave (<http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx?tab=tabs-5>)

Me gjithë krizën financiare në tregjet kryesore, kjo rritje në GNP pritet të vazhdojë në vitet që vijojnë.

- ⇒ Çmimi – niveli i çmimit në vendin mikpritës dhe çmimi përkatës në vendet konkurrese. Konkurrueshmëria e turizmit kryesisht influencohet nga dy faktorë – çmimi dhe cilësia.
- ⇒ Tërheqja e Destinacionit – forca e atraksioneve produkt në vendin mikpritës. Tërheqja e një destinacioni turistik influencohet fuqishëm nga cilësia dhe numri i atraksioneve për vizitorë që ai mund të ofrojë. Përshtatshmëria e akomodimit dhe shërbimet e tjera në plotësimin e nevojave turistëve të sofistikuara në rritje.
Përmirësimi i lidhjeve të transportit mund të stimulojë qartazi rritjen e kërkuesve duke krijuar zona tregjesh të rinj. Zhvillimi i produkteve turistike të interesit të veçantë për të plotësuar nevojat e tregjeve të rinj po bëhet një element kyç në tërheqjen që krijon një destinacion.
- ⇒ Të qënurit i informuar – niveli dhe cilësia e programeve promovionale në stimulimin e informimit të konsumatorëve. Shtrirja dhe efektiviteti i marketingut të destinacionit po bëhet më vendimtar përballë konkurrencës në rritje.

1.2.2 Tendencat e Konsumatorëve

Turizmi ndërkombëtar dhe tregjet e tij po përballen me një ndryshim të paprecedent për shkak të ndryshimeve demografike, ndryshimi i vlerave të stilit të jetesës dhe futja e shpejtë e teknologjisë. Shkollimi dhe eksperiencia formëzojnë sjelljet e konsumatorëve.

Karakteristikat e mëposhtme japin tregues për zhvillimet e ardhshme turistike dhe marketingun për klientelën ndërkombëtare bazuar në pritshmërinë e tyre.

- ⇒ Ata po bëhen më të sofistikuara; më të shkolluar dhe eksperiencë udhëtimit; ata kërkojnë standarte më të larta gjithnjë në rritje. Ata kërkojnë autenticitet më të madh dhe më shumë 'discovery'. 'Discovery' i referohet udhëtimit në vende të panjohura, që kërkon të hulumtohet për të kuptuar vendin ose të kesh dhe një takim të rastësishëm; në thelb – një eksperiencë.
- ⇒ Ata janë të më të moshuar dhe më të pasur, më shumë aktivë fizikisht dhe mendërisht, dhe kërkojnë një numër më të mëdha eksperiencë të orientuar nga aktiviteti.
- ⇒ Ata janë më të vetëdijshëm në një botë me strese në rritje, preferojnë mjedise me pak prezencë njerëzish dhe nuk duan të harxhojnë kohën në udhëtimin nga dhe drejt destinacionit të tyre.
- ⇒ Ata vlerësojnë të mësuarit dhe vetë-përmirësimin. Ata janë shumë më të mprehtë dhe kërkojnë eksperiencë që krijojnë kënaqësi përtej relaksit të thjeshtë. Ata duan të përfshihen në mjedisin e tyre të udhëtimit, të mësojnë aftësi të reja dhe të komunikojnë me komunitetet në vendin e tyre.
- ⇒ Ata kërkojnë për pushime që kanë një impakt të vogël në mjedisin fizik dhe atë natyral.
- ⇒ Ata në mënyrë të vazhdueshme kërkojnë për çmim-shërbim më të mirë dhe struktura kostosh transparente dhe bëjnë gjykime vlerësuese krahasuese mbi një bazë më të madhe globale.

1.3 Tregu Turistik

Turizmi përfshin një varietet segmentesh të tregut. Segmentet kryesore të tregut që ndikojnë në zonat e mbrojtura janë turizmi i masës / 'diell, det dhe rërë', turizmi i natyrës/turizmi i aventurës, ecoturizëm/turizmi me bazë natyrën dhe turizmi kulturor.

1.3.1 Turizmi masiv

Turizmi tradicional 'diell, det dhe rërë' mbetet segmenti më i madh turistik në turizmin ndërkombëtar. Turistët e 'diell, det dhe rërë' kërkojnë pushime relaksuese në mjedise me 'diell, det dhe rërë' dhe argëtim. Pushimet turistike tradicionale të masës 'diell, det dhe rërë' ju shiten turistëve si paketa pushimesh gjithshka-e përfshirë. Ato përfshijnë fluturimet, transfertën lokale, akomodimin dhe vaktet, dhe janë të organizuara dhe marketuara nga touroperatorët në tregjet

origjinë. Gjatë një ose më shumë pushimeve të tyre, turistët mund të zgjedhin të shkojnë në një ose më shumë eskursione për të vizituar atraksionet lokale, të tilla si zonat tregtare, qytetet ose parqe tematike. Por gjithashtu vizitat e tyre mund të përfshijnë qendra të famshme, mjaft prej të cilave mund të jenë në zonat e mbrojtura. Turistët e masës tentojnë të vizitojnë më shumë qendrat kulturore sesa ato natyrore, por disa eskursione përfshijnë vizita në site natyrore për të parë botën e egër, për të shijuar natyrën përreth ose për të marrë pjesë në hiking, shëtitje me anije, zhytje me maskë dhe tub frymëmarrje (snorkelling) ose zhytje me pajisje (scuba diving). Në këtë kontekst, brënda segmentit të turizmit masiv ka një kërkesë në rritje për eskursione në zonat e mbrojtura të cilat ndodhen pranë rezorteve të turizmit masiv.

Turizmi i Bregdetit

Turizmi i bregdetit përkufizohet si turizmi i të gjitha llojeve i lokalizuar në zonat bregdetare dhe i bazuar në kombinimin e burimeve në kufijtë e mjediseve të tokës dhe detit. Prandaj turizmi bregdetar përfshin një grup të shumëllojshëm të tipeve dhe aktiviteteve turistike. Liqenet e mëdhenj gjithashtu ofrojnë parakushte për turizëm bregdetar. Tipet e aktiviteteve të turizmit bregdetar:

Turizmi i Diellit dhe Plazhit

Një tip tradicional i rëndësishëm i turizmit bregdetar është turizmi diell & plazh. Ky tip turizmi karakterizohet nga turisti që kërkon plazhe ranore, rreze dielli, ujë të pastër tërheqës dhe komunikim social atashuar këtij aktiviteti kryesor. Në mes të shekullit të 20-të turizmi diell & plazh në Europë u këthye në turizëm masiv në mjaft destinacione dhe u bë i përballueshëm për pothuajse këdo. Turizmi i diellit dhe plazhit është ende një nga tipet më të mëdha të turizmit.

Turizmi i interesit të veçantë

Zonat bregdetare ofrojnë me kombinimet e tyre në kufijtë e mjediseve të detit dhe tokës mjaft mundësi dhe potenciale për tipe të ndryshme të turizmit të interesit të veçantë:

- Turizmi Detar (nautical)
Turizmi detar mund të përfshijë aktivitete si lundrimin rekreativ, marinat, anijet kruiz, sportet e ujit, turizmin me baze ujin si turizmi i botës së gjallë nënujore (parqet nënujore), histori detare dhe edukim dhe komponente që kanë lidhje me tokën si hotelet/rezortet, kafenetë/resorantet. Tipe të tjerë të turizmit detar janë vozitja me varkë me vela, kruize anije shëtitëse, peshkimi argëtues, skitë e ujit, kurset për të fituar çertifikata të drejtimin të anijeve apo varkave me motor, etj.
- Turizmi i Zhytjes (diving)
Ky përfshin zhytjen në ujra të freskëta si dhe në det, por përjashton të gjitha tipet e zhytjes me maskë dhe tub frymëmarrje (snorkelling). Kërkohe pajisje specialistësh (më e shpeshta një një bombol dhe rregullatori) por gjithashtu vishet kostumi i lagur (ose i thatë) për të mbajtur ngrohtë dhe për t'u mbrojtur. Ndonëse nuk është e rëndësishme që të kesh kaluar një kualifikim zhytjeje për t'u zhytur, shumica e operatorëve që operojnë në mënyrë komerciale do të marrin vetëm klientet të cilët kanë një formë të vlefshme çertifikate, e cila tregon që ata kanë arritur një nivel të caktuar kompetence. Përndryshe ata ofrojnë trainim për të fituar këtë çertifikatë.

1.3.2 Turizmi i Natyrës

Turizmi i natyrës i referohet të gjithë tipeve të turizmit në të cilët motivimi kryesor i turistëve është vëzhgimi dhe shijimi i natyrës gjithashtu dhe kulturës tradicionale që ekziston në zonat natyrore.

Turizmi Aventurës

Turizmi i aventurës është një segment në rritje i tregut turistik specialist. Motivimi kryesor për udhëtimin është aventura sesa të shijosh natyrën. Aktivitetet mund të jenë aventura 'Hard' ose aventura 'Soft'. Aventurë 'Hard' janë aktivitetet e orientuara nga sportet si kacavjerrjet/ngjitjet në mal, hecje me biçikleta malore, trekking, parashuta sportive (paragliding), kayak në ujra të ëmbla, rafting, shpella, surfing, surf me velë, zhytje me pajisje, shëtitje me ballona, etj. Ndërsa

aventurë 'Soft' janë aktivitetet si trekking, hiking, shëtitje me biçikleta, shëtitje me kuaj samari, kamping, ture hecje në këmbë, vëzhgimi i zogjve dhe botës shtazore, kanoe në lumenj dhe liqene, ekoturizëm, etj.. ky mund të përfshijë udhetime në zona të izoluar, disa prej të cilave mund të jenë zona të mbrojtura.

Mjaft aktivitete në natyrë ku turistët e aventurës janë të angazhuar janë potencialisht dëmtes ndaj mjedisit dhe ruajtjes së sitit. Për shembull, ngarja e biçikletave malore mund të shkaktojë dëmtime serioze në shtigjet dhe rrugët në habitatet delikate, gjithashtu shqetësim të përgjithshëm ndaj botes së gjallë. Për këtë arsye, është e rëndësishme të dihen dëmet që çdo aktivitet turistik i aventurës mund të krijojë në mjedisin natyror dhe manaxhmenti i zonës së mbrojtur ti mbajë ato larg nga pjesët më të ndijshme të siteve të zonave të mbrojtura dhe të kufizojë sasinë dhe kohën e ushtrimit të aktiviteteve të aventurës atje. Në anën tjetër, është e rëndësishme të rritet kuptimi ndërmjet turistëve të aventurës për mënyrat e zvogëlimit të ndikimeve të tyre dhe të aktiviteteve të konservimit/ruajtjes në sitit. Tregu turistik i natyrës mund të specifikohet siç tregohet ne Tabelën 1 më poshtë.

Tabela 1: Matrica e Veçorive Treg - Produkt

Tipi	Interesi kryesor	Rëndësia e natyrës së padëmtuar	Kërkesat për Guidat specialistë	Standartet e komfortit të turistëve	Mundësia e kërkesës sasiore
Turistë të natyrës të përkushtuar	Përjetimi i natyrës, interesa të veçanta	Shumë e rëndësishme	Njohuri të veçanta për ekologjinë	Të ulta	I ulët
Turistë të natyrës të interesuar	Përjetimi i natyrës, marrëdhënie reciproke	E rëndësishme	Njohuri të mira për ekologjinë	Të ulta në të larta	Mesatar
Turistë të natyrës të rastësishëm	Lehtësisht i arritshëm, atraksione të dukshme natyrore	Më pak e rëndësishme	Njohuri jo të veçanta për ekologjinë	Mesatare në të larta	Të larta
Turistë të sporteve/aventures	Fokus tek aktivitetet	Natyra si sfond	Njohuri për zonën dhe njohuri teknike	Të ulta	Mesatar në të lartë (zhytjet)
Turistë të gjahut / peshkimit	Fokus tek aktivitetet	Natyra si sfond	Njohuri për zonën dhe njohuri teknike	Të ulta	Të ulta
Turistë të natyrës me interesa kulturore	Përvojë natyrore dhe kulturore	E rëndësishme	Njohuri të mira për ekologjinë dhe shumë të mira kulturore	Të ulta	Mesatar

Burimi: The Ecotourism Training Manual for Protected Area Managers

Ekoturizmi / turizmi me bazë natyrën

Ekoturizmi karakterizohet si udhëtimi i përgjegjshëm në zonat natyrore që mbron dhe respekton mjedisin dhe përmirëson jetesën e banorëve vendas. Objektivi kryesor i Ekoturizmit / turizmit me bazë natyrën është për të vizituar dhe parë mjediset atraktive natyrore dhe botën e egër të tyre. Shembujt janë vëzhgimi i natyrës dhe zogjve, hecjet në këmbë dhe shëtitjet me kalë, zhytjet me pajisje, turet e botës së egër me guidë dhe fotografi të natyrës. Parqet Kombëtare dhe Zonat e Mbrojtura janë arsyeja kryesore për përzgjedhjen e destinacionit të udhtimit.

Sipas vëzhgimit të Organizatës Botërore të Turizmit (UNWTO)⁴ në tregjet kryesore gjeneruese të turizmit, entuziastët e ekoturizmit janë shumica njerëz me arsim të lartë, me eksperiencë

⁴ WTO, 2001. The British Ecotourism Market, World Tourism Organization, Madrid;
WTO, 2001. The German Ecotourism Market, World Tourism Organization, Madrid

udhëtimi, mbi 35 vjeç dhe gratë paksa më të përdorur se burrat. Udhëtimet e ekoturizmit kryesisht zgjasin 8-14 ditë dhe ekoturistët shpenzojnë më shumë se turisti i zakonshëm. Sipas vëzhgimit, potenciali i tregut Gjerman për turizmin ndoshta përfaqëson rreth 14.5 milionë udhëtues në vitin 2000 (total i tregut 48.4 miliona). Ata tentojnë të jenë njerëz tek të 40-at, maksimalisht të shkolluar me të ardhura ndërmjet 1,500-2,500 Eur (50% e tregut) dhe mbi 2,500 Eur pjesa tjetër 50% e tregut. Profili Gjerman është i ngjashëm me atë të tregut të Britanisë së Madhe, Francës dhe Kanadasë, ndërsa tregjet e Spanjës, Italisë dhe SHBA janë pak më të rinj dhe me shpenzim më të ulët.

Ekoturizmi dhe turizmi me bazë natyrën në përgjithësi janë parë si segmentet kyçe të sektorit të turizmit që do të gjenerojnë dhe shpërndajnë përfitimet në ruajtjen. Megjithatë, me qëllim për të fituar çdo përfitim nga ky tip turizmi, është e nevojshme që politikëbërësit, menaxherët e ruajtjes dhe administratorët e zonave të mbrojtura të kuptojnë këto tregje turistike dhe si ti përdorin ato për të tërhequr turistët.

Profili i Tregut Ndërkombëtar për turistët e natyrës/ekoturistët

Preferencat e aktivitetit të turistëve të natyrës/ekoturistëve variojnë sipas tregut origjinë. Sipas Organizatës Botërore të Turizmit (UNWTO), lista e mëposhtme jep disa shembuj

- Gjermania: trekking dhe hiking, safari/ekspedita dhe udhëtime me biçikletë
- Britania e Madhe: soditje e faunës, të qenit në zonat e shkreta, dhe takimi me njerëzit vendas dhe këqyrja e kulturës së tyre
- Franca: vizita në sitet kulturore dhe monumentet, të hecurit në këmbë/trekking, pjesmarrje në festivalet lokale
- Italia: eskursione në natyrë, zbulimi i trashëgimisë natyrore/kulturore dhe zbulimi i produkteve tipike
- Kanadaja: hiking, kamping dhe hecje në këmbë
- SHBA: eskursione mjedisore, shijimi i darkave dhe të bërit pazar

1.3.3 Turizmi Kulturor

Turizmi Kulturor është një formë e turizmit të interesit të veçantë bazuar në pjesmarrjen në eksperiencën të reja kulturore, qofshin ato estetike, intelektuale ose emocionale dhe mbështetet kryesisht në sitet e trashëgimisë dhe shprehjet e kulturës së gjallë.

Tregu i Turizmit Kulturor

Bazuar në vlerësimet e UNWTO dhe Travel & Tourism Intelligence⁵ madhësia e tregjeve të turizmit kulturor besohet të përfaqësojnë më shumë se 60 milion turistë në vit, me një rritje vjetore të projektuar prej 15% deri në vitin 2010. Në varësi të definicionit, e gjithë masa e turizmit kulturor mund të përfaqësojë pothuajse gjysmën e të gjithë turizmit dhe ka treguar masë rritjeje spektakolare për më shumë se një dekadë.

Turistët kulturorë mund ose të jenë turistë të interesit të veçantë ose ata që marrin pjesë në aktivitetet e 'turizmit masiv' por duan to pasurojnë eksperiencën e tyre turistike. Turistët independentë njihen gjithashtu të jenë kuriozë nga ana kulturore dhe përfshijnë një numër të madh të udhtarëve të interesit të veçantë. Ky segment i tregut të turistëve të lirë independentë (FIT- free independent traveller) përfshin një masë të backpackers të cilët përdorin hotele me pesë yje dhe mund të binden të ndryshojnë itineraret dhe të zgjasin qëndrimin e tyre në zonat ku ka aktivitete të interesit të veçantë. Udhëtuesit FIT të kategorisë ekonomike përgjithësisht shpenzojnë më pak për ditë qëndrimi sesa turistët në grup por shpenzojnë në nivelin lokal meqenëse ata përdorin shërbimet e transportit lokal, qëndrojnë në shtëpi pritëse që posedohen nga vendasit dhe ndonjëherë blejnë ture nga agjencitë turistike të vogla që zotërohen nga vendasit.

Turistët kulturorë tentojnë të:

- i përkasin grup moshës 45-64 vjeç dhe janë më shumë femra;

⁵ WTO, Travel and Tourism Analyst, No. 4, 2001 by Travel and Tourism Intelligence

- kanë shkollime universitare dhe nivel të lartë të ardhurash;
- shpenzojnë ndërmjet tetë deri dhjetë përqind më shumë për ditë qëndrimi kur udhëtojnë krahasuar me turistët e pushimit;
- qëndrojnë më gjatë në një destinacion;
- përdorim më shumë akomodim komercial;
- shpenzojnë më shumë në produkte konsumi të tilla si suvenire, artikuj artistik, artizanati dhe veshje;
- kombinojnë eksperiencat kulturore me ato jo-kulturore;
- kërkojnë eksperiencë të mësuarit/edukimit; dhe
- kërkojnë eksperiencë dhe njohuri për një vend dhe njerëz të caktuar (seek a sense of people and place)

Interesat dhe atraksionet variojnë bazuar në formën e turizmit siç tregohet në tabelën 2. Turizmi rural mund të konsiderohet nën çadrën e turizmit kulturor.

Tabela 2: Turizmi dhe Atraksionet Kulturore

Forma e Turizmit	Atraksionet
Turizmi Historik / Arkeologjik	Monumentet historike, rrënojat, gërmimet arkeologjike
Turizmi Etnik	Komunitetet vendase dhe folklori, ndërtimet, mjetet e jetesës, artizanati dhe vendet e shenjta të tyre
Turizmi Rural (agro-turizmi)	Ngrehinat rurale, fshatrat interesante, peisazhet kulturore dhe aktivitetet e fermës, shëtitjet me kalë shale
Udhëtimi i orientuar drejt të mësuarit dhe edukimit	Kurse dhe workshope (mizike, artizanat, mësim gjuhe, mjeksia popullore, valle, ushqim, etj..) të krijuar mbi zanatet autentike vendase

Burimi: Manuali Trajnues i Ekoturizmit për Menaxherët e Zonave të Mbrojtura

1.3.4 Turizmi Rural

Turizmi rural i referohet eskursioneve dhe pushimeve në një mjedis fshati ku kultura rurale është një komponent kyç i produktit në ofertë. Karakteristika veçuese e turizmit rural është kërkesa për qetësi dhe hapësirë për pushim në natyrë në mjedisin rural më shumë sesa të qenit i lidhur në mënyrë të veçantë me natyrën dhe eksperiencë të jetës në fshat që i jep vizitorëve kontakt personal, një shije të mjedisit fizik dhe njerëzor të fshatit dhe aq sa është e mundur të lejojë pjesmarrje të vizitorit në aktivitetet e përditëshme, në traditat dhe mënyrën e jetesës së banorëve vendas.

– Gjatë pushimeve rurale, vizitorët mund të përfshihen në aktivitete/produkte dhe eksperiencë rurale të tilla si: vizita në parqet kombëtare dhe natyrore, hecjet në natyrë/hiking dhe trekking, shëtitje me biçikleta, biçikleta malore, shëtitje me kalë shale, sporte të aventurës, peshkim, gjueti, vëzhgim të zogjve, pushime kampingu dhe karavanesh, trashëgimi turistike në zonat rurale, vizita në sitet historike dhe muzetë, pikturë, arte dhe zejtari, muzikë dhe valle, letërsi, festivale të dramës dhe muzikës, xhiro peisazhistike dhe shijimi i peisazhit rural.

– Fare pranë e lidhur me turizmin rural është agro-turizmi i cili i referohet qëndrimit të momentit të turistëve në ferma dhe pjesmarrja e tyre në aktivitetin e fermës përfshirë të gjitha format e vizitave në fermë për qëllime edukative dhe të kënaqësisë.

Agro-turizmi përfshin të ofruarit turistëve me eksperiencë autentike bujqësore të tilla si aktiviteti i fermës, prodhimi i djathit, vizita në dyqanet e fermës, të shijuarit e ushqimit, pijeve dhe të akomodimit në vendbanimet rurale.

– Strukturat e preferuara akomoduese në turizmin rural janë shtrat & mëngjes, banesa e fermës, pensione dhe hotele të vegjël të stilit familiar, kampingjet, etj.. Struktura akomoduese e preferuar duhet të jetë e vogël – më pak se 15 shtretër, dhe të ofrojë mundësi parkimi për makinat. Të rëndësishme janë sigurimi të një farë standartesh ndërkombëtare në të gjitha strukturat akomoduese. Më të rëndësishmet janë pajisjet sanitare (bide, kloset, lavaman,

pllaka dhe kabina e dushit), standartet higjienike, cilësia e shtratit dhe çështje të sigurisë si instalimet elektrike, shkallët, etj.. E rëndësishme është gjithashtu mjedisi rrethues terheqës, kopshtet, fshatrat ose zonar rurale.

Tregu turistik rural

Turizmi rural është një treg i rëndësishëm në Europë dhe dominohet nga tregu FIT (turistë të lirë independentë) dhe nuk varet aq shumë tek turoperoret. Turistët ruralë europianë janë të etur të:

- Bëjnë rezervimet vetë direkt me ofruesit e akomodimit;
- Përdorin gjërësisht internetin dhe prandaj shërbimet e rezervimit besohet se kërkohen;
- Planifikojnë itineraret e tyre duke përdorur informacionin që ata gjejnë vetë dhe vetë-drejtohen perreth rajonit;
- Shpenzojnë kohë në fshat dhe në parqet kombëtare duke zbuluar kulturën rurale por mundet të provojnë për eskursione të shkurtër në qytetet më të mëdhej për atraksionet kulturore;
- Shijojnë të jetuarit e fshatit dhe do të mirëprisnin mundësinë për të marrë pjesë në aktivitete bujqësore në shkallë të vogël (mbledhje frutash, etj) përfshirë mundësinë për të degustuar gatimet dhe verën vendase;

Pjesa më e madhe e atyre të interesuar në fshatin janë kryesisht prej klasave të mesme dhe lartë dhe i japin domethënie të madhe vlerave dhe identitetit vendas kulturor. Produktet e turizmit rural prirën të kërkohen nga familjet, zakonisht me fëmijë ndërmjet moshave pesë dhe njëmbëdhjetë vjeç, dhe nga çiftet ndërmjet moshave 50 dhe 65. Të parët janë shpesh të tërhequr nga qëndrimi pranë kafshëve të fermës, ndërsa të fundit për cilësitë rurale siç janë ofertat e pushimit. Në terma të përgjithshme, segmentet kryesore të tregut janë familjet, çiftet pa fëmijë dhe të moshuarit.

Rritja e turizmit rural pritet të vazhdojë, megjithatë nuk pritet të jetë një spostim i madh i turistëve drejt këtij segmenti. Megjithatë, ka seksione të tregut masiv turistik të cilët po kërkojnë për një pushim më shumë sipas preferencës larg prej rezorteve kryesore dhe është ky segment që pritet të tërhiqet nga produktet e turizmit rural.

2. PROTECTED AREAS AND RELATED TOURISM ACTIVITIES

2.1 Kategoritë e Menaxhimit të IUCN të Zonave të Mbrojtura

Brënda përkufizimit të IUCN, zonat e mbrojtura janë të menaxhuara për shumë qëllime të ndryshme. Për të ndihmuar në përmirësimin e të kuptuarit dhe për të nxitur ndërgjegjësimin për zonat e mbrojtura, IUCN ka zhvilluar një sistem të zonave të mbrojtura, të identifikuara në bazë të objektivit të tyre kryesor menaxhues (IUCN 2008), siç tregohet në Tabelën 3 më poshtë:

Tabela 3: Kategoritë IUCN për Menaxhimin e Zonave të mbrojtura (IUCN, 2008)

Kategoria	Përshkrimi i Kategorive
Ia	Rezervat i strikt natyror: Kategoria Ia janë zona të mbrojtura strikte të caktuara për të mbrojtur biodiversitetin dhe gjithashtu mundësisht karakteristika gjeologjike /gjeomorfologjike, ku vizitat e njerëzve, përdorimi dhe ndikimet janë të kontrolluara në mënyrë strikte dhe të kufizuara për të siguruar mbrojtje të vlerave konservuese. Zona të tilla të mbrojtura mund të shërbejnë si zona reference të domosdoshme për kërkim shkencor dhe monitorim.
Ib	Zonë e egër: Kategoria Ib zona të mbrojtura janë zakonisht zona të gjëra të pamodifikuara ose pak të modifikuara, duke ruajtur karakterin dhe influencën e tyre natyrore, pa prezencë njerëzore të përhershme ose të rëndësishme, të cilat mbrohen dhe menaxhohen në këtë mënyrë për të ruajtur gjendjen e tyre natyrore.
II	Park Kombëtar: Kategoria II e zonave të mbrojtura janë zona të gjëra natyrore ose afër natyrore të caktuara për të mbrojtur proceset ekologjike në shkallë të gjërë, bashkë karakteristiken plotësuese të specieve dhe ekosistemeve të zonës, të cilat gjithashtu ofrojnë një mbështetje për oportunitete shpirtërore, shkencore, edukative, shlodhëse dhe për vizitorin të pajtueshme në mënyrë kulturore dhe mjedisore.
III	Monument Natyror ose karakteristike: Kategoria III zonat e mbrojtura të caktuara për të mbrojtur një monument natyror të caktuar, i cili mund të jetë një formacion toke, bazament deti, shpellë nënujore, karakteristikë gjeologjike e tillë si një shpellë ose ndoshta një karakteristike jetësore e tillë si një plantacion të hershëm. Ato janë përgjithësisht sipërfaqe shumë të vogla dhe shpesh kanë vlera të mëdha për vizitorin.
IV	Zonë e Menaxhimit të Habitatit/Specieve: Kategoria IV e zonave të mbrojtura ka si qëllim të mbrojtë specie ose habitate të veçanta dhe menaxhimi reflekton këtë prioritet. Shumë zonatë mbrojtura të kategorisë IV do të kenë nevojë për ndërhyrje të rregullta dhe aktive për të adresuar kërkesat e specieve të veçanta ose për të mirëmbajtur habitatet, por kjo nuk është një kërkesë e kategorisë.
V	Peisazh Tokësor/Detar i Mbrojtur: Kategoria V e zonave të mbrojtura ku ndërveprimi i njerëzve dhe natyrës ka prodhuar një zonë me karakter të dallueshëm me vlerë të rëndësishme ekologjike, biologjike, kulturore dhe peisazhistike; dhe ku duke ruajtur integritetin e këtij ndërveprimi është jetësore mbrojtja dhe mbështetja e zonës dhe ruajtja e saj natyrore dhe vlerave të tjera.
VI	Zonë e mbrojtur me përdorim të qëndrueshëm në kohë të burimeve natyrore: Kategoria VI e zonave të mbrojtura ruan ekosistemet dhe habitatet, sëbashku me vlerat e bashkangjitura kulturore dhe sistemet e menaxhimit të burimeve natyrore tradicionale. Ato janë përgjithësisht të gjëra, me pjesën më të madhe në kushte natyrore, ku një pjesë është nën menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ku përdorimi në nivel të ulët jo industrial i burimeve natyrore, i pajtueshëm me ruajtjen e natyrës, shihet si një qëllim kryesor i zonës.

Burimi: IUCN, 2008

2.2 Aplikimi i Kategorisë II (Park Kombëtar) në zonat e mbrojtura detare

Cilado nga kategoritë e IUCN mund të aplikohet në mjediset detare, ndonëse disa mund të jenë më të përshtatëshme sesa të tjerat.

Kategoria II: zonat e mbrojtura janë zona të gjëra natyrore ose afër natyrore të caktuara për të mbrojtur proceset ekologjike në shkallë të gjërë, sëbashku me karakteristikat plotësuese të

specieve dhe ekosistemeve të zonës, të cilat gjithashtu sigurojnë një mbështetje për oportunitete shpirtërore, shkencore, edukative, shlodhëse dhe për vizitorin të pajtueshme në mënyrë kulturore dhe mjedisore

Specifikimi i mëposhtëm, i cili jep një numër drejtimesh menaxhuese, i referohet drejtimit mbi aplikimin e veçantë të kategorive IUCN-së mbi zoant e mbrojtura detare të përcaktuara në Guidelines të IUCN 2008. Aplikimi i Kategorisë II në zonat e mbrojtura detare⁶, si më poshtë:

Tabela 4: Aplikimi i Kategorisë II në zonat e mbrojtura detare

Kategoria e IUCN	Specifikim që lidhet me përdorimin në MPAs
Kat. II	Zonat Kategoria II paraqesin një sfidë të veçantë në mjediset detare, meqenëse ato menaxhohen për 'mbrojtje të ekosistemit', me kushte për vizita, aktivitete pushuese dhe turizëm natyror . Në mjediset detare, përdorimi nxjerrës (i materialeve të gjalla ose të vdekura) si një aktivitet kyç është përgjithësisht jo në përputhje me objektivat e zonave të kategorisë II. Kjo për shkak se shumë aktivitete njerëzore ndonëse të zhvilluara në nivele të ulta (të tilla si peshkimi) tani vërehet se shkaktojnë shterrim ekologjik të burimeve dhe prandaj tani shihen si të papajtueshme me mbrojtjen efektive të ekosistemit. Aty ku përdorime të tilla nuk mund të menaxhohen në mënyrë aktive në një zonë të kategorisë II për të siguruar që objektivat e përgjithshëm të mbrojtjes së ekosistemit plotësohen, vlerësimi mund të nevojitet për t'u dhënë se nëse a duhet lejuar marrje ose nëse objektivat për rezervatin, ose zonën brënda rezervatit, në mënyrë realiste përkojnë me tjetër kategori (psh., kategoria V ose VI) dhe duhet të ndryshojnë.

Source: IUCN 2008

Objektivi kryesor:

- Për të mbrojtur biodiversitetin sëbashku me strukturën e tij ekologjike në të cilën mbështetet dhe proceset mjedisore mbështetës dhe **për të promovuar edukim dhe pushim**.

Objektiva të tjerë:

- Për të menaxhuar zonën më qëllim për të mbrojtur, në një gjendje sa më natyrore të jetë e mundur, shembuj përfaqësues të rajoneve fiziografike, komuniteteve biotike, burimeve gjenetike dhe proceseve natyrore të padëmtuar;
- Për të mirëmbajtur popullata të shëndetëshme dhe funksionale në mënyrë ekologjike dhe grumbullime të specieve vendase në densitete të mjaftueshme për të ruajtur integritetin e ekosistemit dhe aftësinë ripërtëritëse në terma kohorë afatgjatë;
- Për të kontribuar në veçanti në ruajtjen e specieve në masë të madhe, proceseve ekologjike rajonale dhe rrugëve migratore;
- **Për të menaxhuar përdorimin e vizitorit për qëllimet inspiruese, edukative, kulturore dhe pushuese në një nivel i cili nuk shkakton degradim të rëndësishëm biologjik ose ekologjik të burimeve natyrore;**
- Për të pasur në konsideratë nevojat e popullsisë vendase dhe komuniteteve lokale, përfshirë përdorimin e burimeve të jetesës, për aq kohë sa këto nuk do të ndikojnë në mënyrë të pafavorshme objektivat kryesore menaxhuese;
- **Për të kontribuar në ekonominë vendase nëpërmjet turizmit**

Nga përdorimi turistik i burimit në ZMD (Zonat e Mbrojtura Detare) është e rëndësishme të bëhet e qartë nga tabela më sipër "Përcatimet në lidhje me përdorimin e Kategorisë II⁷":

- **Zonat Kategoria II duhet të menaxhohen për "mbrojtje ekosistemi", por duhet gjithashtu të përgatitet për vizita, aktivitete pushuese jo-nxjerrëse dhe turizëm natyror (psh. zhytje me maskë dhe tub ajrimi, zhytje me pajisje, not, shëtitje me varkë, etj.) dhe kërkim (përfshirë format e menaxhuara të nxjerrjeve të kërkimeve)**

Karakteristikat e kategorisë:

- Në mënyrë të veçantë një pjesë e përpjekjeve të menxhimit do të fokusohen në menaxhimin e vizitorëve

⁶ IUCN 2008, Guidelines for Applying Protected Area Management Categories

⁷ IUCN 2012, Guidelines for Applying the IUCN Protected Area Management Categories to Marine Protected Areas

- Shpesh përmbajnë infrastrukturë të konsiderueshme turistike përfshirë rrugët, kampet e turistëve, shtigjet, struktura të vëzhgimit të zogjve dhe qendrat interpretuese, të cilat të gjitha kërkojnë mirëmbajtje të rregullt.

Kategoria IV

Objektivi kryesor

- Të mirëmbajë, ruajë dhe të restaurojë speciet dhe habitatet.

Objektivat të tjerë:

- Të mbrojnë kampionet përfaqësuese të vegjetacionit ose karakteristikat e tjera biologjike nëpërmjet mënyrave tradicionale të menaxhimit;
- Të mbrojnë fragmente të habitateve si komponente të strategjive të ruajtjes së peisazhit tokësor/detar;
- Të zhvillojë edukim publik dhe vlerësim të specieve dhe / ose habitateve që kanë lidhje;
- Të ofrojë umdësinë nëpërmjet të cilës banorët e qendrës urbane të ruajnë kontakt të rregullt me natyrën.

2.3 Pajtueshmëria e formave të turizmit në zonat e mbrojtura

Është e rëndësishme që aktivitetet e turizmit brënda zonave të mbrojtura të jenë në përputhje me objektivat menaxhues të përcaktuar të zonave të mbrojtura.

Tabela 5 më poshtë tregon se një lloj turizmi dhe rekreacioni mund të zhvillohet si një objektivi menaxhues në çdo kategori të zonave të mbrojtura. Për kategorinë II, kategorinë III dhe kategorinë V, turizmi dhe pushimi është një objektivi kryesor. Ndërsa për kategorinë IV, turizmi dhe pushimi është një objektivi mundësisht i aplikueshëm.

Tabela 5: Matrica e objektivave të menaxhimit dhe kategoritë e menaxhimit të IUCN (IUCN, 1994)

Objektivat e Menaxhimit	Ia	Ib	II	III	IV	V	VI
Kërkim shkencor	1	3	2	2	2	2	3
Mbrojtja e kafshëve të egra	2	1	2	3	3	-	2
Ruajtja e specieve dhe e diversitetit gjenetik (biodiversiteti)	1	2	1	1	1	2	1
Mirëmbajtja e shërbimeve mjedisore	2	1	1	-	1	2	1
Mbrojtja e veçorive natyrore / mjedisore -	-	2	1	3	1	3	
Turizëm dhe argëtim	-	2	1	1	3	1	3
Edukim	-	-	2	2	2	2	3
Përdorim i qëndrueshëm i burimeve nga ekosistemet natyrore	-	3	3	-	2	2	1
Mirëmbajtja e tipareve kulturore / tradicionale	-	-	-	-	-	1	2

Çelës: 1= Objektivë parësore; 2= Objektivë dytësore; 3= Objektivë që mund të aplikohet;
- = nuk aplikohet

Burimi: IUCN

Derisa aktivitetet e turizmit dhe pushimit të lejuara brënda Zonës së Mbrojtur Detare përdorin burimet e mbrojtura aty, këto aktivitete përgjithësisht konsiderohen të jenë në kategorinë e ekoturizmit. Shoqata Ndërkombëtare e Ekoturizmit përcakton se ekoturizmi është “*udhtimi i përgjegjshëm në zonat natyrore i cili ruan mjedisin dhe mbështet mirëqënien e popullsisë vendase*”.

Duke i konsideruar tipet e turizmit në dy grupe, ato mund të ndaheshin në “ekoturizëm” (që përfshin aktivitete të aventurës dhe me bazë natyrën) dhe tipe “të tjerë” të turizmit. Tabela 6 më poshtë tregon tipet e turizmit që përputhen me kategoritë e zonave të mbrojtura të IUCN. Grupi i aktiviteteve nën ‘ekoturizëm’ mund të konsiderohen ‘të butë’ ose të ‘fortë’. Aktivitetet e ‘butë’ janë ato ku një drejtim më i rastit, më pak i dedikuar ndërmerrret për aktivitetin ose atraksionin natyror dhe një dëshirë për një eksperiencë me një farë shkalle bazë të komfortit; ndërsa ‘hard’

ekoturizëm përfshin interesin specialist ose aktivitet të dedikuar dhe një dëshirë për eksperience për aktivitete në natyrë ose botën e egër me pak komfort.

Tabela 6: Pajtueshëria / Përshtatshmëria e formave të turizmit me Kategoritë Menaxhuese të Zonave të Mbrojtura të IUCN (sipas lawson, 2001)

Kategoria e zonës së mbrojtur të IUCN	Ekoturizëm 'i forte'	Ekoturizëm i 'butë'	Forma të tjera të turizmit
Ia	Jo	Jo	Jo
Ib	Po	Jo	Jo
II	Po	Po	Jo
III	Po	Po	Jo
IV	Po	Po	Jo
V	Jo	Po	Po
VI	Jo	Po	Jo

Source: IUCN

Zonat e mbrojtura janë mjedise mjaft atraktive për kërkesën në rritje për aktivitete në natyrë në mjedise natyrore. Sfidat për manaxherët e zonave të mbrojtura janë që të sigurojnë se ndërsa vizitorët kanë mundësi të marrin pjesë në aktivitetet e dëshiruara, ata kanë informim dhe mirëmbajnë vlerat e zonave të mbrojtura. Tabela 7 më poshtë është një shembull e një mënyre mjaft të thjeshtë e matjes së pajtueshmërisë hapësinore ndërmjet aktiviteteve. Ajo mund të ofrojë një paraqitje të shpejtë nëse papajtueshmëria hapësinore është absolute ose ku menaxhimi ekstra mund të mundësohet për të maksimalizuar bashkë-përdorimin dhe pajtueshmërinë.

Tabela 7: Vlerësime të pajtueshmërisë hapësinore të tipeve të ndryshme të përdorimit të detit.

	Gjeneratorë ere ne det	Zona të mbrojtura detare	Peshkimi	Deti si një mirë publike	Kabllot	Turizmi	Rrugët e anijeve	Portet	Bujqësia	Nxjerrja e rërës dhe inerteve	Kërkim nafte dhe gazi	Hedhje materialesh të gërmuara	Kultura detare dhe ujore	Qendra bregdetare shërbimi	Ruajtje e natyrës	Mbrojtja e bregdetit	Përdorim ushtarak
Gjeneratorë ere ne det		x	x	x			x			x	x	x					x
Zona të mbrojtura detare	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x				x
Peshkimi	x	x	x	x	x		x		x	x			x				x
Deti si një mirë publike	x	x	x				x			x	x	x	x				x
Kabllot		x	x				x		x	x	x	x			x		
Turizmi		x													x	x	x
Industria e anijeve dhe rrugët	x	x	x	x	x					x	x	x	x				x
Portet		x											x		x		
Bujqësia		x	x	x									x		x		
Nxjerrja e rërës dhe inerteve	x	x	x	x	x		x			x	x	x	x		x	x	
Kërkim nafte dhe gazi	x	x		x	x		x			x	x	x	x				x
Hedhje materialesh të gërmuara	x	x		x	x		x			x	x	x	x				
Kultura detare dhe ujore		x	x	x			x	x	x	x	x	x	x		x		x
Qendra bregdetare shërbimi															x		
Ruajtje e natyrës					x	x		x	x	x			x	x		x	x
Mbrojtja e bregdetit						x				x					x		x
Përdorim ushtarak	x	x	x	x		x	x				x		x		x	x	

x = i papërputhshëm; x = i përputhshëm me kusht; Fushë e bardhë = i përputhshëm

Burimi: Marine Spatial Planning (Gee et al. 2006)

3. MENAXHIMI I TURIZMIT NE ZONAT E MBROJTURA

Zonat e mbrojtura janë mjaft atraktive për kërkesën në rritje për natyrë, aktivitete vlerësuese në mjediset natyrore. Sfidat për menaxherët e zonave të mbrojtura qëndrojnë për të siguruar që ndërsa vizitorët kanë mundësi të marrin pjesë në aktivitetet e dëshiruara, ata i kuptojnë ato dhe mirëmbajnë vlerat e zonës së mbrojtur. Mbrojtja e burimeve natyrore dhe trashëgimive kulturore shërben si bazë për zhvillimin e turizmit. Zhvillimi i turizmit në zonat e mbrojtura duhet të orientohet në aspektin mbrojtës, kështu ai nënkupton të refuzohet zhvillimi nga disa vendodhje dhe/ose nga promovimi i disa aktiviteteve. Në këtë pikë, ai garanton zhvillimin e mundshëm të turizmit në kohë të gjatë.

3.1 Ndikimet mjedisore të aktiviteteve të turizmit

Si rezultat i rigjallërimit të interesit për natyrën, gjithnjë e më shumë njerëz po vizitojnë zonat e mbrojtura të tilla si Sitet e Trashëgimisë Botërore, Rezervatet Biosferë, Parqet Kombëtare, Parqet natyrore, etj.. Ndikimet mjedisore të lidhura me turizmin zakonisht ndodhin si rezultat i kombinimit të një sërë faktorësh: përdorimi i ekosistemeve të ndjeshme, numër i madh vizitorësh dhe / ose sjellje e papërshtatshme e vizitorëve, aktivitete të papërshtatshme në Zona të Mbrojtura (ZM) të veçanta, mungesë e një menaxhimi të përshtatshëm të ZM. Efektet negative të shkaktuara nga turizmi mund të jenë serioze ku veçanërisht ndikohen specie ose habitate të ndjeshme, edhe nëse përfshihet një numër i vogël vizitorësh.

Tabela 8 më poshtë jep një klasifikim të nivelit të ndikimit mjedisor që aktivitete të ndryshme pushimi dhe sportive në natyrë krijojnë sipas vendit ku ato zhvillohen në mjedisin natyror.

Tabela 8: Klasifikimi i aktiviteteve në natyrë të pushimit dhe atyre sportive sipas ndikimit të tyre të mundshëm mjedisor

	I ULET	MESATAR	I LARTE
Aktivitete dëbore	Cross-country skiing (ski ne terren)	Backcountry skiing (ski jashtë piste)	Skitë alpine
Aktivitete në tokë	Turizmi çiklistik Admirim i Naturës Hedhje nga lartësitë me litar elastik (Bungee-jumping) Trajtime kurative (Spa) Turizmi Kulturor Turizmi mësimor Tourizmi Rural	Alpinizëm Banja Bicikleta malore Komping Ushqim në fshat Ngjitje në shkëmbinj Evente në natyrë Speologji Eskursione Peshkim Ecje në natyrë Turizmi i kalërimit	Kamping jo i rregullt Gjuetia Foto-gjuetie Golf Safari Ngarje makine 4 rrota aktive Motokros Vizitat e shpellave
Aktivitete në ajër	Fluturim me avione model Fluturim me ballon	Paragliding Hang-gliding Gliding	Hedhje me Parashute
Aktivitete uji	kanoe Rowing Serf – serf me velë Shëtitje me jaht	Kanoe në ujra të ëmbla Hydrobob Hydrospeed Rafting	Ravine descent Ski uji Gara me varka të shpejta Jet-skiing Ski uji ne lumej Zhytje
Përqindja	30.74%	56.29%	13.17%

Source: ECOTRANS

Ndjekja e aktiviteteve të turizmit të sporteve në Zonat Natyrore rregullohet nga dispozitat e Planeve Menaxhuese të Burimeve Natyrore dhe Planet e Përdorimit dhe Menaxhimit të Zonave respektive. Kujdes duhet të bëhet për kufizimet e zonës dhe përdorimet e lejuara atje.

Gjithashtu, ndikimet mjedisore mund të shkaktohen nga komponentë të ndryshëm të turizmit dhe duhet të merren në konsideratë kur zhvillohen Planet e Menaxhimit, sipas rrethanave:

- Aktivitetet e vizitorëve dhe infrastruktura që lidhet me to (shtigjet, etj.)

- Transporti (rrugët, mjetet, etj.)
- Sjellja e ofruesve të shërbimeve (guidat, shoferët, mbajtësit e bagazheve, etj.)
- Infrastruktura e akomodimit dhe ushqimit dhe shërbimet (ndërtimi i godinave, operimi i shërbimeve)
- Infrastruktura që lidhet (furnizimi me ujë, kanalizimet, furnizimi me energji, hedhja e mbeturinave, etj)
- Zhvillimet indirekte të krijuara (imigrimi i fuqisë puntore, shitësve, etj. në zonë) që çojnë në konsumimin e shtuar të burimeve në zonë

Aktivitetet e tjera të lidhura me turizmin që mund të jenë të dëmshëm për mjedisin janë sportet ujore të tillë si zhytjet dhe jet-skiing. Zhytjet, veçanërisht nëse shoqërohen me peshkim nënujor, mund të jenë një problem serioz nëse praktikohen në zonat e ndijshme ekologjike ose ku ka koncentrim të madh të zhytësve, të cilët mund të shkaktojnë shqetësim për faunën dhe dëmtim të gjallesave ose eliminim të pak specieve ekzistuese në disa pjesë të caktuara të bregdetit dhe pengojnë ripërtëritjen e tyre.

Ndërmjet ndikimeve më negative të turizmit në zonat e mbrojtura vlejnë të përmendet të mëposhtëmet:

- Ndërtimi i infrastrukturës turistike ose komunikacionit në zonat e mbrojtura, që çon në ndikime negative direkte ose indirekte
- Prezenca e njerëzve shkakton stres dhe ndryshime mjedisore në sjelljen e kafshëve. Nëse nuk menaxhohet siç duhet, koncentrimi i madh i vizitorëve në kohë të veçanta të vitit mund të rrezikojë rolin ruajtës të zonave në fjalë.
- Futja e specieve të huaja rrezikon ekuilibrin delikat të popullimeve ekzistuese në zonë.
- Gjuetia ilegale ka rezultuar në shfarosjen e shumë specieve të kafshëve dhe peshqve, duke shkaktuar dëmtim të riparueshëm për popullatat e rrezikuara.
- Mbeturinat e lëna pas aktivitetit përkeqësojnë kushtet dhe janë një rrezik shëndetësor për speciet e mbrojtura.
- Kafshët shpesh goditen nga makinat që udhëtojnë me shpejtësi përmes këtyre zonave.
- Disa aktivitete, të tilla si ngjitjet, zhytjet, etj., mund të dëmtojnë jetën e kafshëve dhe prandaj ka priirje për ti kufizuar në disa pjesë të zonave të mbrojtura.

3.2 Infrastruktura turistike në zonat embrojtura

Infrastruktura për vizitorët duhet të plotësojë një sërë funksionesh në lehtësimin e përdorimit për turizëm të një zone. Tipet e mëposhtëme të infrastrukturës mund të veçohen sipas qëllimit të tyre të veçantë:

- Infrastruktura që lehtëson disa eksperiencë: pika shikimi (platforma, kulla), maskime për të vëzhguar botën e egër, etj..
- Transporti dhe infrastruktura e lëvizjes:
 - a) Rrugë të shtruara ose jo për transport të motorizuar përfshirë parcelat e parkimit; në përputhje me objektivin për të promovuar aktivitete të qeta, trafiku i motorizuar brenda ZM duhet mbajtur në minimum, por mund të jetë i përvitueshëm për shkak të distancave të gjata dhe sigurisë së vizitorëve (botë shtazore e rrezikshme)
 - b) Shtigjet: përmbushin një rol dyfish duke ofruar vizitorëve mundësinë për aktivitete fizike (shëtitje, hiking, trekking) dhe të shijojnë natyrën përveç funksionit të tyre për të shkuar nga pika A në pikën B; shtigje të veçanta mund të ofrohen për biçikletat dhe kalërimin e kuajve me samar
 - c) Rrugët e ujit: skelat dhe bankinat përgjatë rrjedhave të përshtatëshme dhe në buzëliqene; udhtimi me anije (e motorizuar ose jo) në ZM është zakonisht një atraksion në vetvehte
- Infrastruktura në lidhje me informacionin: shenjat drejtuese (brenda dhe jashtë ZM), shenjat që informojnë vizitorët rreth rregullave, sjelljeve të duhura, etj..
- Infrastruktura interpretuese: ekspozita, stenda në ambjente brenda ose jashtë në natyrë, tabela, etj.. në pikat e shikimit dhe përgjatë shtigjeve interpretues
- Infrastruktura që plotëson nevojat e ndryshme fizike të vizitorëve: zonat e pushimit, zonat e piknikut, tualetet, shatërvanet, strehët

- Pikat e aksesit dhe zonat e pritjes: sheshe parkimi dhe shërbime të ndryshme për të informuar vizitorët që vijnë dhe kontrolli i hyrjes (kabina e biletave, porat e hyrjes)
- Infrastruktura akomoduese: sheshet e kampingut, kasollet, shtëpizat
- Dyqanet dhe shërbimet e ushqimit
- Strehimi i stafit
- Shërbimet e rrjeteve të furnizimit dhe hedhje së mbeturinave (ujë, mbeturina, energji)
- Qendrat e vizitorëve janë shpesh pikat kryesore në parqe dhe mund të koncentrojnë disa funksione në të njejtën zonë, të tilla si pritja e vizitorëve, informimi dhe interpretimi, zonat e pushimit, dyqanet, përgatitja e ushqimit, strukturat e akomodimit. Si të tilla ato duhet të vendosen siç preferohet në periferi të ZM, çfarë do t'u mundësonte atyre të shërbenin si lidhje ndërmjet anës së jashtme dhe brendësisë së parkut.

Dizenjimi i infrastrukturës së vizitorëve përgjithësisht duhet të plotësojë objektivat si më poshtë:

- ti sigurojë vizitorët me një sërë mundësishë atraktive që të krijojnë eksperiencë të natyrës dhe peisaxhin, duke filluar nga eksperiencat e vendbanimeve të veçuara në zonat më të populluara në të cilat mund të arrihet lehtësisht
- të respektojë mjedisin natyror dhe minimizojë ndikimin në botën e gjallë, ekosistemet natyrore dhe kaqarakteristikat e tjera natyrore
- të jetë praktike dhe e përdorshme në mënyrë miqësore

Këto principe bazë përkthehen në konsideratat e mëposhtëme për projektuar një sistem të shtigjeve dhe pikave të shikimit:

- seleksionimi i vendeve (për pikat e shikimit) dhe hedhja e gjurmës së shtigjeve është vendimi i parë për t'u marrë. Ai duhet të sigurojë akses karakteristikave më interesante të parkut ndërsa shmangen ekosistemet e ndjeshme ose habitatet e gjallesave. Në mënyrë alternative, ndikimet negative ndonjëherë mund të zbuten nga infrastruktura e projektuar në mënyrë të veçantë (psh. rrugë shëtitëse në duna ose zonat moçalore për të mbrojtur vegjetacionin; maskime për të fshehur vizitorët nga kafshët)
- rekomandohet një sistem shtigjesh me gjatësi të ndryshme dhe shallë të ndryshme vështirësie
- shtigjet duhet të jenë të thjeshtë dhe duhet të duken sa më natyral të jetë e mundur, megjithëse të hecurit në to duhet të jetë më e lehtë sesa në zonat përreth. Gjithashtu, shtrimi ose masa të tjera mund të kërkohet me qëllim të menaxhohet rreziku i erozionit. Në zonat që përdoren më shumë (zakonisht që tërheqin personat me më pak eksperience dhe dhe më pak të përgatitur fizikisht) shtigjet duhet të jenë të gjërë, me sipërfaqe të shtruar dhe karakteristika të mundëshme suplementare (të tilla si shkallare ose mbajtëse dore në seksione të vështira)

3.3 Mekanizmat financiarë në zonat e mbrojtura

Ndërsa turizmi mund të jetë një burim përfitimi për zonat e mbrojtura, në mjaft raste, zonat e mbrojtura mund të mos kenë burimet ose akses për investimet që nevojiten për të shndëruar këto përfitime të mundëshme në realitet dhe mund të mos jenë mjaftueshëm të pajisur për të kontrolluar dhe menaxhuar turizmin kështu që ai të qëndrojë në ballancim me qëllimet ruajtëse. Prioriteti i parë për zonat e mbrojtura është të gjejë mënyrat e punës me sektorin e turizmit për të reduktuar ndikimin e turizmit dhe kostot në një zonë të menaxhimit të turizmit, përpara zbulimit të mundësisë së përdorimit të turizmit për të rritur të ardhurat që mund të kontribuojnë në menaxhimin e zonës së mbrojtur. Së dyti, ku zonat e mbrojtura janë në gjendje të marrin para nga turistët dhe bizneset për hyrjen dhe përdorimin e këtyre zonave, ka kosto të përfshira në sigurimin e infrastrukturës së nevojshme, edhe nëse është në nivel bazë dhe në menxhimin e turizmit në zonat e mbrojtura. Zonat e mbrojtura ofrojnë mundësi për turizëm, ndërsa sektori komercial i turizmit ofron mundësitë dhe shërbimet për turistët të vizitojnë zonat e mbrojtura – nëpërmjet akomodimit, kateringut dhe transportit, gjithashtu dhe marketingut. Turizmi i suksesshëm në zonat e mbrojtura kërkon aftësinë për të zhvilluar dhe marketuar produktet turistike bazuar në zonat e mbrojtura dhe aftësinë për të mirëmbajtur cilësinë e këtyre zonave për të ardhmen.

3.3.1 Modelet Financues

Investimet në projektet e akomodimit miqësore me mjedisin dhe me shans për sukses në zonat e mbrojtura do të jenë të vështirë për shkak të sezonalitetit të turizmit. Përdorimi i një programi të nënshkruar për të promovuar praktika dhe principe mjedisore dhe me bazë komunitetin do të mundësojë rajonin të zhvillojë standarte dhe kritere që janë vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit.

Kutia 1: Ndërto – Drejto – Transfero (Build – Operate – Transfer)

Modeli Ndërto – Drejto – Transfero është provuar mjaft efektiv në menazhimin e tregjeve ku dëshirohen biznese të qëndrueshëm. Modeli lejon që investitorët privatë të hyjnë në një treg të ri me pak pengesa shtetërore. Investitori original lejohet të operojë investimin fillestar për një periudhë kohe të caktuar me incentiva të tjerë shtetërore duke lejuar ata të maksimalizojnë fitimet e tyre në një periudhë të shkurtër shfrytëzimi pa dëmtuar gjendjen e përgjithshme të investimit në periudhën afatgjatë të shfrytëzimit. Sapo periudha e caktuar kalon, lehtësohet transferata e biznesit nëpërmjet shitjes.

Investitori fillestar mund ti jepet incentiva shtesë për të shitur pronën të tilla si koncesione për fitimet e kapitalit për kompanitë me fitim të transferuara. Këto investime janë në mënyrë të veçantë të mëdha dhe në sektorë që mund të zhvillohen duke mbështetur industrinë bashkë me prezencën e tyre.

Disa përfitime të investitorëve janë:

- Mundësia të hyjnë në treg herët dhe krijojnë mardhënie
- Përrjashtim nga taksat, shtyrje afatesh, dhe ndërprerje
- Fitime në kohë të shkurtër
- Emër i mirë brenda dhe jashtë vendit në rastin e zhvillimit të tregjeve të rinj
- një strategji e identifikuar e largimit

Disa përfitime të komunitetit janë:

- Punësim i lartë vendas
- Mundësi për zgjerim sipërmarrës
- Zhvillim i industrive mbështetëse
- Trainim në vendin e punës në industrinë e turizmit me shanse fitimi
- transferim i kapitalit intelektual dhe dijeve të biznesit

Përfitimet e qeverisë përfshijnë:

- Rritje e volumit ekonomik të bizneseve në zonat e varfëra
- Rritje e të ardhurave nga taksat në kohë të gjtë
- Reduktimi i varësisë lokale nga programet qeveritare të mbështetjes

Qëllimi i fundit i modelit Ndërto – Drejto – Transfero është vetë-qëndrueshmëria. Transferata e bizneseve të qëndrueshme dhe më fitim si dhe praktikatat më të mira të biznesit në popullsitë lokale për përdorim në një operim në vazhdimësi, janë gjithashtu qëllime të këtij modeli.

Një model i thjeshtë ekonomik i turizmit në zonat e mbrojtura

Figura 1 më poshtë tregon një model të thjeshtuar të pagesave, taksave dhe të ardhurave të lidhura me turizmin dhe zonat e mbrojtura⁸. Zonat e mbrojtura janë në gjendje të marrin fonde nga këto tre burime kryesore:

- ⇒ nëpërmjet financimeve shtetërore,
- ⇒ duke vendosur një pagesë hyrjeje për vizitorët dhe
- ⇒ duke vendosur pagesa për bizneset që operojnë brenda kufijve të zonave të mbrojtura.

⁸ Font, X., Cochrane, J., and Tapper, R. (2004) Tourism for Protected Area Financing: Understanding tourism revenues for effective management plans, Leeds (UK): Leeds Metropolitan University

Tarifa e hyrjes

Kjo është një tarifë e paguar nga vizitorët me qëllim për të hyrë në zonën e mbrojtur ose zonë tjetër ekoturizmi. Ajo mund të mblidhet në hyrje të zonës ose më parë në një qendër tjetër administrative. Kur mblidhet në hyrje të zonës së mbrojtur paguhet një tarifë për njeri ose makinë, në mënyrë alternative turoperatorët mund të blejnë bileta në avancë kështu që vizitorët në turet e organizuar kanë të përfshirë pagesën në koston totale të paketës së tyre. Sfidat në lidhje me mbledhjen e suksesshme të tarifës së hyrjes mund të përfshijnë mbledhjen joeficiente të tarifave, të cilat rezultojnë në humbje të të ardhurave nga tarifat e hyrjes nga zonat e mbrojtura dhe është një burim korrupsioni.

Në vendet në zhvillim, tarifat diferencuese janë të zakonshme; vendasit paguajnë më pak se vizitorët e huaj. Kjo inkurajohet për disa arsye:

- Banorët rezidentë të një vendi (dmth, vendi i vendodhjes së ZM) paguajnë tashmë për ruajtjen e zonave të mbrojtura nëpërmjet taksave;
- Objektivat e edukimit mjedisor dhe pushimit të zonave të mbrojtura normalisht kërkojnë të inkurajojnë vizitat e popullsisë vendase; dhe
- Të huajt nga vendet e zhvilluara janë përgjithësisht janë të gatshëm të paguajnë më shumë për hyrjen në zonat e mbrojtura.

Kutia 2: Raste studimi

Bonaire, Netherlands Antilles: Parku Detar i Bonaire operon një sistem tarife përdorimi prej 10 US\$. Zhytësit furnizohen me një etiketë zhytjeje për të treguar se ata kanë paguar tarifën e cila është e vlefshme për një vit. Tarifa e zhytjes mblidhet për llogari të parkut nga turoperatorët. Përderisa të gjithë zhytësit kanë nevojë të marrin bombolat nga një operator, funksionimi është afër 100% - megjithëse ka ca riciklime të etiketave, me të vjetrat i kalohen të rinjve të sapoardhur nga zhytësat ose operatorët. Në përgjithësi, zona e mbrojtur detare ka një marrëdhënie të mirë punë me operatorët, të cilët duhet të marrin p-jesë në një kurs rifreskimi të përvitshëm. Parku tërhoqi rreth 345,000 vizitorë në 2001 në të 86 vendet e zhytjes të cilat gjeneruan rreth \$280,000 në tarifë zhytjeje. Në vitin 2000, 80-90% e kostove të menaxhimit të parkut u mbuluan nga këto të ardhura. Kërkimi tregon se zhytësit kanë një gatishmëri të theksuar më të lartë për të paguar për hyrjen në park. Çmimi i një etiketë zhytjeje prej 20 US\$ do të rezultonte në një të ardhur vjetore më shumë se \$506,000 dhe do të shoqërohej vetëm 6% rënie në visita. Studimi gjithashtu tregon se tarifa më të larta mund të përdorehin për të kufizuar aksesin e zhytjes në zona të veçanta kur ka përkeqësim të lidhur me zhytës-densitet. Megjithatë, ka rezistencë nga an e operatorëve të zhytjes për një tarifë në rritje dhe në vend të saj forma të tjera të rritjes të ardhurave të konsiderohen (tarifa për snorkelling, pagesa për ancorimin e jahteve).

St. Lucia: Autoriteti i Menazhimit Detar të Soufrière zbaton dy tarifa zhytjeje të Rezervatit detar, një vjetore dhe një ditore (\$12 dhe \$4 respektivishtbajtë), ndërsa mbajtësit e maskave me tub ajrimi (snorkellers) të paguajnë \$1 në ditë. Argumentimi për këtë është se mbajtësit e maskave me tub ajrimi (të gjykuar se janë më pak të pasur se zhytësit) nuk do të tërhiqen. Lejet mund të blihen nga operatorët e zhytjes, drejtuesit e licencuar të zhytjes ose në zyrën e Autoritetit të Menazhimit Detar të Soufrière. Aplikohen gjithashtu tarifa për varkat të cilat shkojnë nga \$10-\$25 (shuma varet nga madhësia e varkës/anijes dhe gjatësia e qëndrimit).

Kohët e fundit Parku Arkeologjik i Butrinit ka prezantuar një sistem të ri elektronik të biletave, të financuar nga Fondi i Zhvillimit Shqiptaro-Amerikan. Mënyrat nga të cilat bileta elektronike mund të rrisë të ardhurat nga biletat janë nëpërmjet burimeve të reduktuara të zyrës së biletave dhe shitjeve të rritura për arsye se çdo vizitor numërohet shpejt dhe në mënyrë të saktë.

Tarifat e Lejimit

Kjo është një tarifë e mbledhur për përdorimin e shërbimit ose aktivitetit të veçantë të tillë si një muzeum ose klasë fotografie.

Tarifat e Përdorimit

Kjo tarifë ju merret vizitorëve për ndërmarrjen e aktiviteteve të veçanta ose për përdorim të shërbimeve të specifikuara brënda zonave të mbrojtura, subjekt në përputhje me rregulloret e zonës së mbrojtur (psh. për parkim, kamping, peshkim, gjueti, shëtitje me anije/varkë, zhytje, hiking, programe pushimesh, sporte, fotografi, etj.).

Liçenca ose Leje

Këto janë tarifa që ju merren turoperatorëve për t'i lejuar ato të menaxhojnë vizitorët në zonat e mbrojtura, psh. poseduesit e anijeve shëtitëse. Në mënyrë tipike, ato nevojitet të rinovohen çdo vit dhe mund të përdoren menaxherët e zonave të mbrojtura si një mënyrë për kontrollin dhe kufizimin e aksesit në një zonë. Në vijim, ato mund të jepen për të lejuar vizitorin të ushtrojë një aktivitet specifik që kërkon supervizion/menaxhim të veçantë sepse merr pjesë në aktivitet në mënyrë jo të shpeshtë ose sepse kërkesa për këtë aktivitet duhet të porcionohet me qëllim të reduktohet ndikimi i njeriut dhe / ose ofrohet për një eksperience të veçantë të vizitorit të tillë si një nivel i lartë i vetmisë. Ai është një mekanizëm i mirë për monitorimin se sa vizitorë aktualisht ushtrojnë një numër aktivitete. Guidat dhe turoperatorët mund gjithashtu të kenë nevojë për leje të veçanta për të punuar në vend, për të cilën zakonisht paguhet një tarifë.

Shitjet

Në mjaft raste, administrata e zonës ose palë të treta mund të shesin suvenire, ushqim dhe produkte të tjera për vizitorët brënda zonës. Përfitimi nga këto shitje është një tjetër burim i të ardhurave. Veçanërisht ku shitjet kanë interes, fitimi duhet kalkuluar në mënyrë të kujdeshme mbas zbritjes të gjitha kostove, të tilla si blerjet/prodhimi i produkteve, kostot e punës, etj. Palët e treta duhet gjithashtu të krijojnë një fitim përpara se administrata e zonës të marri përqindjen.

Konçesionet & Qeratë

Konçesionet dhe qeratë janë kontratat ndërmjet zonave të mbrojtura dhe bizneseve ose individëve sipas të cilave këto biznese ose individë lejohen të operojnë brënda zonës së mbrojtur dhe të përdorin një hapësirë ose shërbime të zotëruara nga ZM për një periudhë të specifikuar kohore në këmbim të pagesave për ZM dhe në përputhje me rregulloret e zonës.

Konçesionet dhe qeratë mbulojnë një sërë lelesh, qerashë dhe liçencash. Janë kritere të zakonshme që ato të lejojnë kompanitë private ose individët të drejtojnë operacione komerciale brënda një zone të mbrojtur ndërsa gjenerojnë përfitime financiare për zonën e mbrojtur. Aktivitetet mund të përfshijnë guidë të tureve, menaxhim trekingu ose zhytjeje, ofrim akomodimi, restorante, dyqane suveniresh, peshkim sportiv ose eskursionet gjuetie, kalërim, dhënie me qera të kayakeve ose të biçikletave malore dhe dhënie me qera ose shitja e pajisjeve për sporte të tjera dhe rekreacioni. Një konçesion ose qera mund të konsistojë në një tarifë të paguar autoritetit të zonës së mbrojtur përgjatë një kohe të rënë dakord (ose vjetore ose në avancë), ose sasia mund të ketë lidhje me të ardhurat e konçesionarit, ose tarifa mund të përfshijë elemente të të dyjave. Konçesionet ose liçencat mund të lëshohen për kompanitë private, grupeve të komunitetit, ose OJF ose sipermarrjeve të tjera jo-fitim prurëse dhe mund të ofrojnë një mënyrë për të siguruar që komunitetet që jetojnë brënda dhe përreth zonës së mbrojtur të mund të përfitojnë nga ajo ekonomikisht.

Taksat

Një metodë e mëtejshme e financimit të zonave të mbrojtura është nëpërmjet taksave. Taksat – tarifat mbi disa mallra, shërbime ose transaksione që sigurojnë fonde për qeverisjen qendrore ose lokale dhe të cilat në këtë rast përdoren për të mbështetur zonat e mbrojtura. Këto mund të marrin formën e taksave kombëtare të mbledhura nga të gjithë vizitorët në vend ose nga përdoruesit e shërbimeve ose produkteve të veçanta turistike, taksat lokale të mbledhura nga përdoruesit e zonave të mbrojtura ose për përdorimin e pajisjeve. Të ardhurat e krijuara përdoren për konservim. Tarifat e shtratit janë të zakonshme në mbarë botën, dhe kjo është më efektivja kur zona është brënda një bashkie ose zone të mbrojtur. Zonat e mbrojtura kanë nevojë të jenë realiste rreth mundësive për të krijuar fonde nga turizmi. Shumica e zonave të mbrojtura që kanë krijuar fonde domethënëse nga turizmi fokusohen në zonat e potencialit të madh turistik, shpesh në zonat e zhvilluara ose zonat me infrastrukturë dhe tregje turistike të mirë zhvilluar¹¹.

Planet e menaxhimit të turizmit do të nevojiten aty ku turizmi zhvillohet në ndonjë zonë të mbrojtur, dhe duhet të integrojnë realitetet e biznesit të turizmit me qëllimet ruajtëse të zonave. Në mënyrë ideale këto plane duhen përgatitur më përpara se aktivitetet e turizmit.

¹¹ Font, X., Cochrane, J., and Tapper, R. (2004) Tourism for Protected Area Financing: Understanding tourism revenues for effective management plans, Leeds (UK): Leeds Metropolitan University

Kutia 3: Parku Detar i Bonaire

Ishulli i Bonaire është pjesë e Karaibeve Hollandeze në Antilet e Vogla. Ujrat e ishullit, duke u shtrirë në një kontor që shkon 60m thellësi janë ligjërisht të mbrojtura si Park Detar qysh nga viti 1979. Pjesën më të madhe të vizitorëve në ishull e përbëjnë zhytësit. Menaxhimi i Zonës së Mbrojtur Detare pasqyron qartazi potencialin për implementimin e suksesshëm të një sërë mekanizmash menaxhimi dhe është një nga ZMD të para në botë që është e vetë-finacuar. Proçedurat janë relativisht të thjeshta, por efektive:

Zhytësit paguajnë një pagesë pranimit si një proçedurë standarte e kontrollit të tyre. Pagesat mbliidhen dhe i kalohen Parkut Detar në tërësinë e tyre, pa kostot administrative. Sapo paguajnë pagesën e pranimit, zhytësit janë të gatshëm të marrin informacion mbi Parkun detar, përfshirë rregullat dhe rregulloret dhe aktivitetet e tij/ atyre ju jepet informacion interpretues dhe ju kërkohet të ndjekin një orientim me zë. Së fundi, ata janë të detyruar zhvillojnë një zhytje orientuese në rezort përpara se ata të lejohen të zhyten diku tjetër në Parkun Detar. Kërkimi ka treguar se përpjekjet i edukojnë zhytësit dhe në këtë mënyrë minimimi i ndikimit të tyre në koralet ka qenë shumë i suksesshëm. Më tej, zhytësit raportojnë shpejt ndonjë shkelje të rregulloreve (1997).

Pagesat e përdorimit kontribuojnë më tej për mirëmbajtjen e sistemit të ankorimit të parkut, pë rratitjen e shënjesve të bregut dhe mirëmbajtjen e strukturave dhe pajisjeve të parkut, më tej në financimin e një programi bamirësie për fëmijë, aktivitete për zbatimin e ligjit dhe një sërë projektesh kërkimi dhe monitorimi. Ndërsa zhytja me pajisje thithje ajri është forma kryesore e turizmit, strategjitë e përdorura për të menaxhuar atë duhet të konsiderohen për aktivitete të tjera detare.

3.3.3 Kostot dhe përfitimet për zonat e mbrojtura

Në vendet në zhvillim gjenerimi i të ardhurave është një nga arësyet kryesore – në mos më e rëndësishmja – për të zhvilluar ose mbështetur në mënyrë aktive ekoturizmin në zonat e mbrojtura. Deri tani, megjithatë, potenciali financiar i ekoturizmit nuk është realizuar plotësisht. Në shumicën e rasteve vetëm një pjesë shumë e vogël e shpenzimeve të përgjithëshme të udhëtimit kalon tek administrata e zonave të mbrojtura. Kjo për shkak të një numër arësyesh, pavarësisht gatishmërisë së lartë të shumicës së ekoturistëve për të paguar për ruajtjen e atraksioneve natyrale. Kompanitë private të turizmit shpesh vendosin tarifa përdorimi duke cituar presionin e çmimeve nga destinacionet konkurruese dhe përdorimi jo transparent i tarifave nga administratat e ZM. Principet dhe rekomandimet e mëposhtëme¹² duhet të verifikohen me qëllim që realizohet në mënyrë efektive potenciali financiar i ekoturizmit:

Tipet e të ardhurave:

- Nga turistët: tarifa e hyrjes për struktura të veçanta (psh. sheshe kampingu) ose shërbime nga biznese turizmi: shitjet, konçesionet, liçenca ose tarifa lejesh
- Tarifat e gjuetisë, liçencat e peshkimit
- Krijimi i burimeve shtesë të të ardhurave (dyqanet, restorantet, dhe strukturat turistike)

Kriteret për vendosjen e tarifave

- Atraktiviteti i burimeve dhe cilësisë së infrastrukturës dhe shërbimeve turistike
- Potenciali i tregut (gatishmëria e vizitorëve për të paguar një nivel të caktuar parash)
- Kthimi / përfitueshmëria e kostove (e ardhura duhet të kalojë ose të paktën të barazojë kostot për infrastrukturën turistike, shërbimet dhe menaxhimin)
- Diferencimi tarifave për grupe të ndryshme (psh. të huajt kundrejt vendas; grupet edukimit)
- Përdorimi i tarifave si instrument i menaxhimit të vizitorëve (psh. për të ulur visitat në zonat më shumë të ndikuara ose për të rritur atë në zonat më pak të vizituara ose jashtë sezonit)
- Fleksibilitet sipas ndryshimit të situatave (psh. ndryshime në kërkesë)

¹² Strasdas W., 2002. The Ecotourism Training Manual for Protected Area Managers

Përdorimi i të ardhurave

- Mbeshtet shërbimet dhe infrastrukturën turistike
- Siguron përdorim për qëllime konservimi
- Siguron përdorim për popullsinë vendase (psh. pagesa kompensuese, trainime)
- Shmang shkurtime të fondeve shtetërore

Konsiderata Shtesë

- Krijon një strukturë institucionale adekuate për menaxhimin e turizmit dhe menaxhimin e të ardhurave nga turizmi (organizate autonome, OJF, fond i besueshëm, konçesionar privat)
- Zhvillon një plan biznesi për investimet dhe menaxhimin e turizmit
- Ndërsa merren tarifët, ofrohet diçka në shkëmbim (psh. broshurë) dhe komunikohet përdorimi i tarifës
- Siguron transparencë në përdorimin e tarifave, veçanërisht për ata të cilët i paguajnë ato.

3.3.4 Pjesmarrja Vendore dhe Zona e Mbrojtur

Pjesmarrja e aktorëve të përfshirë në turizëm ose që mund të ndikohet nga ai është thelbësore për menaxhimin e integruar të turizmit dhe biodiversitetit. Kjo pjesmarrje duhet gjithmonë të përfshijë komunitetet lokale që mund të ndikohen ose përfshihen në turizëm. Kutia 4 më poshtë paraqet principet kryesore që duhen të ndiqen kur merren në konsideratë popullsia lokale dhe zona e mbrojtur. Këto principe duhet përputhen me politikat dhe planet e veprimit që të inkurajojnë punësimin dhe rritjen e ekonomisë lokale në një mënyrë të qëndrueshme.

Kutia 4: Popullsia Lokale dhe zonat e Mbrojtura – Principet Kryesore

- ⇒ Popullsia lokale duhet përfshirë plotësisht në formulimin e vendimeve rreth objektivave dhe politikave menxhuese
- ⇒ Nevojat e komunitetit lokal duhen adresuar dhe informacioni i dalë nga këto konsultime duhet të përdoret në planifikimin dhe menaxhimin e zonës së mbrojtur
- ⇒ Krijimi dhe menaxhimi i zonave të mbrojtura duhet koordinuar me sigurimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve, gjithashtu dhe zhvillimin e përdorimin e qëndrueshëm të tokës rurale
- ⇒ Mirëmbajtja e biodiversitetit bujqësor, e furnizimit me lëndë djegëse, linjave të mbarështrimit, sistemit foragjer dhe menaxhimit të varieteteve duhet të sigurohet sepse popullsia lokale mund të mos ketë mundësitë e duhura për mbështetjen e menaxhimit të zonës së mbrojtur derisa ata të arrijnë prodhim më të madh në aktivitetet e tyre kryesore ekonomike dhe të plotësojnë nevojat e tyre bazë
- ⇒ Seleksionimi dhe trainimi i stafit lokal të zonës së mbrojtur duhet parë si kritik në marrëdhënie me përfshirjen e komunitetit. Pozicione të tilla si konsultimi i komunitetit nevojitet të zhvillohet
- ⇒ Duhet vlerësuar dhe analizuar modelet e suksesshme të përfshirjes së komunitetit, me përhapjen e gjërë të rezultateve. Nevojitet gjithashtu të ndahet eksperiencia ndërmjet atyre që punojnë në kontekste të ndryshme kulturore dhe ekonomike.

Burimi IUCN 1994

Administrata e parkut Kombëtar duhet prandaj të jetë një nga përshpejtuesit për të ndihmuar komunitetin e parkut në çështjet e zhvillimit social dhe ekonomik, por nuk mund dhe nuk duhet të veprojë në rolin e një agjencie zhvillimi. Administrata e Parkut Kombëtar, në zhvillimin e aktiviteteve të saj, do të punojë në partneritet me grupet e aktorëve vendorë, agjencitë dhe organizatat e zhvillimit për të mbështetur ekonominë dhe komunitetet ruarale në mënyrat të cilat do të ruajnë dhe përmirësojnë cilësitë e veçanta të Parkut Kombëtar.

Drejtimet¹³ in Kutinë 5 më poshtë kërkojnë një numër pyetjesh të cilat janë të vlefshme në identifikimin e aktorëve kryesorë për një zonë të mbrojtur.

¹³ IUCN 2003, Guidelines for Management Planning of Protected Areas

Kutia 5: Drejtime në indentifikimin e aktorëve kryesore

Individët kryesorë me influencë në zonat e mbrojtura mund të përfshijnë:

- Ministra dhe drejtorë të autoritetetve të tjera të menaxhimit të tokës dhe burimeve
- Lidera të komunitetit lokal, grupe veprimi ose shoqata të përparimit
- Pronarët e tokës dhe të shtëpive
- Të ardhurit, përfshirë ata që praktikojnë fermerin dhe ata që kanë prona me qera, ose me liçence ose me qera pranë zonës së mbrojtur
- Managerë biznesi, fuqia puntore dhe përfaqësuesit e tyre të përfshirë në aktivitete të ndryshme ekonomike të tilla si furnizimi me ujë, pyjet, nxjerrja e mineraleve, peshkim dhe turizëm
- Planifikues, menaxhere dhe fuqia e tyre puntore e zonave të mbrojtura,
- Përfaqësuesit e atyre që organizojnë ose influencojnë vizitorët në zonë për aktivitete pushimi dhe të kohës së lirë
- Kërkues shkencorë të zonave ose projekteve në zonë ose pranë saj

Pyetjet e mëposhtëme mund të ndihmojnë për të identifikuar aktorët kryesorë:

1. Cila është marrëdhënia e njerëzve brënda zonës – si e përdorin dhe vlerësojnë ata atë?
2. Cilat janë rolet dhe përgjegjësitë e tyre të ndryshme?
3. Në çfarë mënyrë ata mund të ndikohen nga ndonjë iniciativë menaxhuese?
4. Cili është ndikimi aktual i aktivitetit të tyre në vlerat e zonës së mbrojtur?

Burimi: IUCN 2003

Pjesmarrja dhe konsultimi i aktorëve i aplikuar në të gjitha aspektet e planifikimit dhe menaxhimit që lidhen me turizmin dhe biodiversitetin, përfshin përgatitjen e planeve strategjike të zhvillimit, planet e zhvillimit të komunitetit dhe vlerësimin dhe vendim-marrjen sipas propozimeve specifike për aktivitetet dhe zhvillimin e turizmit. Aktorët e mundshëm përfshijnë¹⁴, por nuk janë të kufizuar në:

Sektori Publik

- Autoritetet e bashkisë
- Autoritetet rajonale
- Nivele të ndryshme të qeverisë përgjegjëse për turizmin dhe asetet e tij kryesore
- Ministrinë dhe agjencitë e tjera në fushat që ndikojnë turizmin

Sektori Privat

- Tur operatorët dhe agjencitë e udhimit
- Akomodimi, restorantet and atraksionet, dhe ato që lidhen me to
- Transporti dhe ofrues të tjerë shërbimesh
- Guida, interpretues dhe furnizuesit
- Ofruesit e ofertave për industrinë
- Shoqatat e bizneseve turistike
- Organizatat e zhvillimit të bizneseve

OJF-të

- Grupet mjedisore
- Grupet konservues
- Grupet e tjera të interesit (gjuetarë, peshkatarë dhe shoqata të sporteve/aktiviteteve të aventurës)

Komunitetet

- Komunitetet vendase
- Grupet e komunitetit vendas
- Grupe kulturore
- Lidera të shquar

¹⁴ UNEP, User's Manual on the CBD Guidelines on biodiversity and Tourism Development

Turistët

- Organizatat përfaqësuese të turistëve në rajon dhe pikat e origjinës
- Organizatat ndërkombëtare të turizmit

Zonat e mbrojtura mund të jenë përshpejtues për zhvillimin rural duke ofruar mundësi për zhvillimin e shërbimeve dhe marketingun e produkteve të prodhuara aty në vend. Ndërsa do të ketë kontrolle dhe masa të vendosura për të menaxhuar Parkun, theksi duhet vendosur në maksimalizimin e ndërthurjes pozitive ndërmjet menaxhimit të Parkut dhe banorëve vendas. Prandaj është parësore që interesat e popullsisë lokale jo vetëm konsiderohen në procesin e menaxhimit, por që masa aktive merren për të inkurajuar pjesmarrjen dhe përfshirjen e komunitetit vendas në aktivitetet dhe përfitimet e krijuara të parkut.

Pjesmarrja e komunitetit në ekoturizëm mund të bazohet në vetë ZM, ose produktet suplementare mund të zhvillohen bazuar në atraksionet kulturore meqenëse mjaft ekoturistë interesohen gjithashtu në eksperiencat të tilla. Tabela më poshtë jep një përmbledhje të tipeve të pjesmarrjes lokale ekonomike në turizëm

Tabela 10: Tipet e pjesmarrjes lokale ekonomike në turizëm

Lloji i pjesmarrjes	Niveli aftësisë së kërkuar	Niveli delegimit të kompetencës	Siguria e kthimit (risiku)	Drejtimi i përfitimeve	Kontributi në zhvillimi lokal
Marrja e pagesave të përdorimit të ZM	Asnjë	Asnjë	E sigurtë	Komuniteti si një i tërë	E ulët
Shitja e tokës tek investitorët	Asnjë ¹	E ulët	Shumë e sigurtë	Individët ose komuniteti si një i tërë ²	E ulët
Qera toke ose delegim i të drejtës së përdorimit	Asnjë ³	E ulët	E sigurtë	Individët ose komuniteti si një i tërë ⁴	E ulët
Punësim nga investitorë	E ulët në të mesme ⁵	E ulët	Një farë sigurie	Individët (mundësisht përfshirja e antarëve më të varfër)	E mesme
Ofrimi i ushqimeve dhe shërbimeve	E ulët në të mesme ⁶	E ulët në të mesme	Një farë sigurie	Individët (anëtarët aktivë të favorizuar më shumë)	E mesme
Joint Venture Komunitet – Sektor Privat	E mesme	E mesme në të lartë	Një farë sigurie	Individët aktive dhe komuniteti si një i tërë ⁷	E lartë
Ndërmarrje Komuniteti e pavarur	E lartë	E lartë	E sigurtë	Individët aktivë dhe komuniteti si një i tërë ⁸	E lartë
Ndërmarrje individuale vendase	E lartë	E lartë	E sigurtë	Individët aktivë	E lartë

Burimi: *The Ecotourism Training Manual for Protected Area Managers*

- 1 Përveç aftësisë për të negociuar kushte të përshtatëshme
- 2 Në varësi të pronësisë mbi tokën
- 3 Përveç aftësisë për të negociuar kushte të përshtatëshme
- 4 Në varësi të pronësisë mbi tokën dhe të drejtave të përdorimit
- 5 E lartë për pozicione të kufizuara
- 6 E lartë për drejtime të kufizuara
- 7 Në varësi të marrëveshjes me investitorin
- 8 Në varësi të marrëveshjes ndërmjet komunitetit dhe grupit që drejton ndërmarrjen

3.3.5 Pjesmarrja Lokale në Zonën e Orikumit

Eksperiencat e derisotme tregojnë se përfshirja e popullatës lokale të Orikumit është e ulët në organizatat apo shoqata aktive¹⁵ ndonëse banorët do të preferonin që Bashkia të organizonte më shumë takime publike dhe t'i përfshinte në vendim-marrjen lokale. Ndërsa gratë janë disi aktive dhe marrin pjesë në mjaft takime të organizuara nga njësitë e qeverisjes vendore, të rinjtë tregojnë interes në aktivitete të organizuara nga bashkia në tema si mbrojtja e mjedisit, aktivitete kulturore, etj. Popullsia lokale duket se është e gatëshme të përshtasi banesat dhe objekte të tjera të tyre për të ofruar akomodim për turistë¹⁶, si shtrat e mëngjes, etj..

¹⁵ Puka, M., December 2012. Socio-Economic Study for the MCPA Karaburun – Sazan

¹⁶ SIM Spa, iMed, 2005. Heritage Assets Mapping - Albania Integrated Coastal Management and clean-up Program

4. STRUKTURA INSTITUCIONALE E TURIZMIT

4.1 Institucionet që influencojnë turizmin në nivel qëndror

- Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MoTCYS) është përgjegjëse për krijimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Turizmit, strukturën e plotë ligjore për zhvillimin e turizmit, procesin që lidhet me planifikimin dhe zhvillimin, mbështetjen për administratën rajonale dhe organizimin e turizmit në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MoEFWA) është përgjegjëse për politikën mjedisore dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore që do të mundësojë zhvillimin e turizmit në zonat e mbrojtura nëpërmjet menaxhimit dhe administrimit të Zonave të Mbrojtura dhe Parqeve Kombëtare, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve, rregullat e aksesit, skemat e shlyerjes së investimeve gjithashtu dhe vlerësimin e ndikimit mjedisor të turizmit.
- Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Komunikimit (MoPWTC) është përgjegjëse për planifikim urban, mirëmbajtjen e rrugëve dhe investimet për rrugët e reja turistike, zhvillimi i transportit detar dhe transportin e aviacionit civil në zonat me prioritet turizmin.
- Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive për zhvillim rural, gjithashtu për çështje të lidhura me cilësinë dhe sigurinë e ushqimeve dhe pijeve.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës siguron programet e shkollimit përfshirë kurrikulën e turizmit dhe atë të trainimit për punonjësit e kualifikuar të turizmit.
- Ministria e Brendshme ka rolin e mbjedhjes së statistikave të imigracionit, gjithashtu dhe koordinimin me pushtetet vendore.
- Ministria e Finances është një ministri kryesore për zhvillimin e turizmit, veçanërisht në fushën e politikave të taksave dhe caktimin e buxhetit.
- Banka e Shqipërisë ka një rol kryesor në koordinimin dhe mbledhjen e statistikave që lidhen me turizmin.
- Instituti i Arkeologjisë dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës (nën Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve).
- Shoqatat e Sektorit Privat të interesuara për turizmin.
- Donatorët e huaj me rol aktiv në mbështetjen e turizmit

4.1.1 Struktura Administrative e Turizmit

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është përgjegjëse për çështje të politikave të turizmit, siç përcaktohet në Ligjin e Turizmit¹⁷, Neni 6. Përgjegjësitë e tjera janë mbështetja, mbrojtja, zhvillimi dhe promovimi i burimeve turistike dhe trashëgimisë kulturore në bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore qendrore, me sektorin turistik privat dhe shoqërinë civile.

Kompetenca më e spikatur e MTKRS në lidhje me Zonën e Mbrojtur Karaburun – Sazan, janë vëmendja për të në politikën kombëtare dhe dokumentat e planifikimit për zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT)

Agjencia Kombëtare e Turizmit është një ent publik nën juridiksionin e Ministrisë përgjegjëse për turizmin. Rolet kryesore të AKT janë realizimi i funksioneve që lidhen me promovimin dhe marketingun e turizmit, gjithashtu dhe funksione të tjera të dhëna në Ligjin e Turizmit.

¹⁷ Ligji i Turizmit Nr.9734, datë 14.5.2007 (i ndryshuar)

Kompetencat më të spikatura të AKT në lidhje me Zonat e Mbrojtura, janë aktivitetet e saj të marketingut të tilla si prodhimi dhe shpërndarja e publikimeve promovionale, portali zyrtar i turizmit, vizitat familiarizuese, PR, panairët turistike, etj., që marrin në konsideratë promovimin e potencialeve dhe aktivitetet turistike të zonave të mbrojtura.

Broshura të ndryshme të botuara nga AKT pasqyrojnë ose përmendin gadishullin e Karaburunit, Parkun Kombëtar Llogara, ishullin e Sazanit dhe atraksionet dhe aktivitetet e lidhura me zonën të tilla si Parku Arkeologjik i Orikumit, shpella e Haxhi Alisë, plazhi i Gramës, mbishkrimet e plazhit të Gramës, zhytjet nënujore, etj.. Broshura 'Shqipëria – trashëgimia nënujore', një guidë xhepi (versioni elektronik i publikuar në faqen e internetit të MTKRS) jep informacion mbi nënujin e gadishullit të Karaburunit dhe mundësive të zhytjeve nën ujë dhe atraksioneve që mund të vizitohen atje.

Ndërsa në në faqen zyrtare të internetit (www.albaniantourism.com) nuk ka fare informacion mbi zonën detare Karaburun – Sazan dhe atraksionet aty. Aty përmendet vetëm Parku Kombëtar i Llogarasë.

Zyra e Shërbimeve Turistike (ZSHT)

Zyrat Rajonale të Shërbimit Turistik janë krijuar (2010) në 9 rajonë në Shqipëri, përfshirë Vlorën. Zyrat Rajonale të Shërbimit Turistik ndodhen nën juridiksionin e Ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe kanë detyrën të japin informacion për turistët në lidhje me hyrjen, shërbimet dhe strukturat e vlefshme dhe informacion mbi sitet dhe atraksionet që ju interesojnë turistëve, gjithashtu trajtimi i ankesave të bëra nga turistë shqiptarë dhe të huaj kundrejt hotelierëve, drejtuesve të restoranteve turistike, guidave turistike, agjentëve të udhëtimit, turoperatorëve dhe bizneseve të tjera turistike në lidhje me produktin ose shërbimin që ju ofrohet atyre.

4.1.2 Aktorë të tjerë

Biznesi i Turizmit

Në nivel kombëtar, dy shoqata biznesesh operojnë në fushën e turizmit. Njëra prej tyre, Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA, <http://www.ata.org.al/>) është krijuar (2008) me asistencën financiare dhe teknike të GTZ dhe përfaqëson një shoqatë çadër të bizneseve nga sektorët e hoteleve, organizuesve të udhëtimit dhe restoranteve. Ajo numëron rreth 200 antarë. Shoqata tjetër, Unioni i Operatorëve Turistikë Shqiptarë, përfaqëson një grup agjentësh udhëtimi dhe agjenci transporti.

Disa nga operatorët vendas, përveç promovimit të biznesit të tyre, kanë përfshirë në broshurat e tyre promovimin mbi atraksionet kulturore dhe natyrore të Shqipërisë, përfshirë Parqet Kombëtare dhe gjithashtu informacion turistik. Janë 4-5 operatorë zhytjeje që operojnë duke ofruar shërbime zhytjeje në zonën e Karaburunit.

Donatorët ndërkombëtarë me rol aktiv në turizëm

Turizmi Shqiptar (sektori publik dhe ai privat) ka marrë mbështetje të konsiderueshme nga donatorët ndërkombëtarë të cilët luajnë një rol aktiv në mbështetje të tij. Donatorët kryesorë që kanë mbështetur çështje të turizmit janë UNDP, USAID, GTZ dhe SNV.

Organizma ndër-ministrior

Komiteti për menaxhimin e Zonës së Mbrojtur Bregdetare Marine Karaburun – Sazan. Me anë të urdhërit Nr 441, datë 16.08.2012 është krijuar komiteti i menaxhimit me përfaqësues nga departamentet ministriore si M oEFA, MoTCYS, MoPWTC, qeverisja vendore, OJF, sektori privat, etj..

Komiteti i menaxhimit është përgjegjës për administrimin e zonave të mbrojtura nëpërmjet zbatimit të planit të menaxhimit të zonës. Komiteti i menaxhimit të zonës së mbrojtur ka detyrë të:

- Kontribuojë në hartimin e planit të menaxhimit të zonës, të sigurojë përputhshmërinë e tij me strategjinë dhe planet vendore e sektoriale të zhvillimit, duke u kujdesur që këto të

- fundit të respektojnë kërkesat për mbrojtjen e zonës ;
- Organizojë, monitorojë zbatimin e planit të menaxhimit të zonës dhe të veprimtarive të liçensuara, që zhvillohen në të ;
 - Japë mendim për kërkesat për përdorimin e burimeve natyrore të zonës, si dhe për pajisjen me leje mjedisore për veprimtaritë që do të ushtrohen në të ;
 - Miratojë elementët e hollësishëm të kërkesave për lidhjen dhe zbatimin e kontratave nga administrata e zonës me subjektet private e shtetërore, vendase apo të huaja, për ushtrimin e veprimtarive në këtë zonë, kundrejt pagesave përkatëse ;
 - Analizojë kryerjen e detyrave dhe të funksioneve të administratës së zonave të mbrojtura ;
 - Analizojë raportin për të ardhurat dhe shpenzimet financiare dhe të përcaktojë drejtimin e investimeve në zonë ;
 - Miratojë rregulloren e hartuar nga administrata e zonës së mbrojtur që garanton ruajtjen, përdorimin dhe administrimin e saj ;
 - Miratojë raportin dyvjeçar të gjendjes së zonës së mbrojtur, i cili publikohet 2 muaj pas miratimit ;
 - Propozojë ministrit të mjedisit, në bazë të studimeve të kryera ndryshime në planin e menaxhimit të zonës, zgjerimin e kufijve, si dhe masa shtesë për përmirësimin e cilësive të saj ;
 - Shqyrtojë ankesat e pronarëve dhe të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në zonë ndaj veprimeve të administratës së zonës ;
 - Kërkojë organeve përkatëse ndalimin e zbatimit të projekteve dhe të veprimtarive që edhe pse zhvillohen jashtë zonës, kanë ndikim negativ në të apo bien ndesh me planin e menaxhimit të saj ;
 - Kërkojë nga kryeinspektori i mjedisit kontrolle në veprimtaritë që ushtrohen në zonë dhe përreth saj, për të zbutur dhe shmangur ndikimet negative në të ;
 - Nxisë hartimin dhe zbatimin e projekteve për përmirësimin e cilësive të zonës ;
 - Bashkërendojë me Ministrinë e Turizmit për promovimin e zonave të mbrojtura edhe si zona me interes turistik.

4.2 Politika Kombëtare e Turizmit dhe Parqet Kombëtare

Megjithëse në Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2007-2013 deklarohet se produkti kryesor turistik i Shqipërisë duhet të mbështetet në kulturën dhe natyrën, nuk ka politika të veçanta në lidhje me zhvillimin e Parqeve Kombëtare si qendra turistike. Për momentin, një Strategji e re Kombëtare e Turizmit 2013-2020 është në proces dhe duhet të adresojë këtë çështje.

4.3 Konteksti Lokal i Zhvillimit të Turizmit

4.3.1 Funkzioni i Turizmit në nivel lokal

Në qarqet dhe bashkitë/komunat, në nivel rajonal/lokal, departamenti për zhvillim ekonomik është gjithashtu përgjegjës për turizmin dhe një ose më shumë punonjës janë caktuar të merren me çështje të turizmit. Përgjithësisht ato kanë mungesë të ekspertëve të turizmit.

Vetëm bashkitë ose destinacionet kryesore të turizmit, Vlorë e përfshirë, përpiqen të prodhojnë broshura / fletëpalosje promociionale rreth atraksioneve të tyre turistike dhe shërbimeve të ofruara, ose organizojnë evente / aktivitete kulturore si eventet me rastin e hapjes së sezonit turistik veror, panaireve dhe festivaleve lokale, etj..

Kuk kanë një faqe interneti të veçantë (psh., www.visit.vlora) për promovimin e turizmit në territorin e Vlorës. Ndonëse, Qarku Vlorë, Bashkia Vlorë dhe Bashkia Orikum kanë një seksion mbi turizmin në faqen e tyre të internetit (ndërmjet aktiviteteve të tjera ekonomike), informacioni mbi shërbimet dhe atraksionet turistike në territor mungon fare ose është i paplotësuar dhe vetëm në shqip. Atraksionet turistike paraqiten dhe promovohen jo mjaftueshëm. Informacioni mbi zonën e mbrojtur dhe atraksionet në të është i pamjaftueshëm dhe jo i pasqyruar siç duhet. Çfarë ju mungon këtyre faqeve të internetit është informacioni i

përshtatshëm turistik i orientuar nga tregu, të tilla si ku të rrih (informacion mbi hotelet, shtëpitë vendase), çfarë të bësh/ku të shkosh (informacion se çfarë të vizitosh, çfarë aktivitete dhe strukturash janë të mundshme në vend), si të shkosh atje (drejtimet për në vende/atraksione të veçanta), ku të hash (informacion mbi restorantet, veçanërisht ata me kuzhinë tradicionale). Konkretisht:

Qarku Vlorë: faqja e internetit <http://www.qarkuvlore.gov.al>

Mungon informacioni në anglisht. Informacioni mbi turizmin natyror dhe kulturor është i përcipët dhe jo lehtë i aksesueshëm (downloadim i informacionit në vend të hapjes së faqes). Nuk ka informacion fare për restorante, hotele agjenci turistike që operojnë në territorin e qarkut.

Bashkia Vlorë: faqja e internetit <http://www.bashkiavlore.org>

Ka informacion në anglisht për atraksionet natyrore dhe trashëgiminë kulturore, por informacioni për zonën e mbrojtur dhe atraksionet e lidhura me të mungojnë. Nuk ka informacion fare për restorante, hotele agjenci turistike që operojnë në territorin e bashkisë.

Bashkia Orikum: faqja e internetit <http://www.orikum.gov.al>


Ka informacion të detajuar se çfarë mund të vizitosh, zejet dhe kuzhinën tradicionale në territorin e bashkisë Orikum, por ai është vetëm në shqip. Informacioni mbi zonën e mbrojtur është mjaft i pakët. Ka informacion të detajuar për një numër strukturash akomodimi dhe restorante që operojnë në territorin e bashkisë.

4.3.2 Planifikimi i Territorit

a. Funkzioni i planifikimi të territorit në nivel lokal

Këshilli Rajonal është organi përfaqësues i rajonit. Komunitet dhe bashkitë delegojnë antarët e tyre në Këshillin Rajonal. Kryetarët e Bashkive janë gjithmonë antarë të Këshillit Rajonal. Në nivel rajonal, autoriteti kryesor i planifikimit të territorit është Këshilli Rajonal, i cili në bazë të ligjit për qeverisjen lokale ka përgjegjësinë për zhvillimin rajonal, planifikimin urban dhe zhvillimin e territorit.

Tabela 11 Autoritetet e Planifikimit të Territorit dhe rruga e miratimit të instrumentave vendorë të planifikimit



Source: Metohu, G. 2010

Autoritetet lokale (komuna/bashki) janë përgjegjëse për zhvillimin e planeve orbane për territorin e tyre. Megjithatë, miratimi i planeve është përgjegjësi e autoriteteve rajonale. Komunat dhe Bashkitë kanë kompetencë dhe përgjegjësi të zhvillojnë dhe mbrojnë territorin e tyre nëpërmjet aprovimit të instrumentave lokal të planifikimit në përputhje me instrumentat kombëtare dhe rajonale të planifikimit. Këshilli i Planifikimit të Territorit të komunës/bashkisë është përgjegjëse për miratimin e instrumentave lokal të planifikimit në nivel lokal.

Bashkia Orikum ka një Plan Urban për qytetin e Orikut të aprovuar vite më parë nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit (KKRT), por është i pezulluar në bazë të ligjit të ri për planifikimin hapësinor, i cili kërkon që të gjitha studimet duhet të rishikohen në përputhje me kërkesat e ligjit.

b. Struktura Institucionale e autoriteteve të planifikimit të territorit

Planifikimi i Territorit është i organizuar në (1) nivel kombëtar, (2) nivel rajonal dhe (3) nivel lokal. Në Tabelën 14 më poshtë jepet skematikisht struktura institucionale e autoriteteve të planifikimit në territorin në nivelet qendror, rajonal dhe lokal dhe aprovimi i instrumentave të planifikimit të territorit.

5. TRAINIMI I STAFIT, OPERATOREVE DHE SIPERMARRESVE

5.1 Shkollimi Zyrtar në Subjektet e Turizmit

Kurset e mëposhtëme janë të vlefshshme në subjektet e turizmit:

5.1.1 Shkollimi i Nivelit Universitar

Janë pesë universitete që ofrojnë kurse të menaxhimit të turizmit si vijon:

- Universiteti i Tiranës nën fakultetin e ekonomisë ofron kursin 3-vjeçar në marketing me një specializim në turizëm.
- Universiteti i Vlorës nën fakultetin e ekonomisë ofron kursin 3-vjeçar në menaxhim turizmi.
- Universiteti i Shkodrës nën fakultetin e ekonomisë ofron kursin 3-vjeçar në menaxhim turizmi.
- Universiteti i Korçës nën fakultetin e ekonomisë ofron kursin 3-vjeçar në menaxhim turizmi dhe një kurs mastër në turizëm. Kursi i menaxhimit të turizmit duket se është më i ploti përse i përket shkollimit të turizmit në Shqipëri.
- Universiteti i Durrësit nën fakultetin e biznesit ofron kurse 3-vjeçare me profile që lidhen me turizmin si Menaxhim Hotel-Restorante, Turizmi Arkeologjik, Menaxhim i Turizmit Kulturor.

5.1.2 Shkollimi Profesional

Ka tre shkolla profesionale që ofrojnë trainim në hotel dhe turizëm në Shqipëri. Këto janë:

- Shkolla Hoteleri dhe Turizëm në Tiranë, e cila u krijua në 1995 dhe u mbështet nga Kulturkontakt (Austria) për pajisjet profesionale, planifikimi i kurrikulës, trainim i mësuesve dhe trainim i menaxhmentit të shkollës. Shkolla ndjek sistemin “3+2”, që është, 3 vjet bazë të trainimit kryesisht në kuzhinë, shërbime, recepsion, dhe teknika udhëtimi; 2 vjet shtesë për përgatitjen e studentëve më të mirë në pozicione manaxheriale.
- Shkolla Hoteleri dhe Turizëm në Sarandë është hapur në vitin 1999 dhe është mbështetur nga Kulturkontakt (Austria) në mënyrë të ngjashme si në Tiranë. Shkolla ndjek sistemin “3+2” në kurrikulën e saj.
- Shkolla e Hotelierisë Durrës është hapur në vitin 1997 dhe është mbështetur nga Chambre des Métiers, Loire & Chère (France) për pajisje profesionale, planifikim dhe zhvillim të curriculave dhe trainim të mësuesve. Shkolla ndjek sistemin “3+2” në kurrikulën e saj.

5.2 Trainimi për Turizmin me Bazë Komunitetin

Trainimi për ekoturizëm dhe ndërmarrjet e vogla nuk konsiderohet akoma një prioritet në qarqet akademike. Prandaj, shumica e njerëzve të cilët trainohen në shërbimet e hotelierisë dhe kateringut nuk do të ofrojnë vetë shërbime në shkallë të vogël ekoturizmi.

Trainimi për ndërmarrjet e reja të shkallës së vogël të ekoturizmit dhe agroturizmit dhe produktet është vendimtare për zhvillimin e ekoturizmit dhe agroturizmit në kompleksin zone e mbrojtur ‘Karaburun-Rreza e Kanalit-Orikum-Tragajs-Dukat’. Ai mund të iniciohet nëpërmjet inkubatorit ekoturizmit që duhet krijuar ose nga ndonjë organizëm tjetër profesional trainimi në turizëm.

Për pasojë, shumica e operatorëve potencialë të cilët janë të vendosur në Orikum dhe në fshatrat përreth në zonën e mbrojtur dhe të cilët mundën të ofrojnë biznese të vogla turistike nuk do të kenë trainim të rregullt turizmi ose biznesi të çfarëdo lloji. Mbështetja e këtyre njerëzve me këshilla do të jetë kritike nëse një industri e cilësisë së lartë dhe e suksesëshme ekoturizmi do të krijohet dhe zgjerohet në të ardhmen. Transferim i dijeve të mbështetur nga kurse të vogla të specializuara shihet si metoda kryesore e arritjes së këtij qëllimi.

Në përgjithësi ka një defiqit të dijeve në fushat në vazhdim që konsiderohen të jenë fushta kryesore për trainim:

- Basa e ekoturizmit
- Si të drejtosh një biznes
- Kontabiliteti i thjeshtë
- Marketing
- Kujdesi klientit

5.3 Transferimi i Dijeve

në rastin e mungesës së mundësive për kurse të rregullta trainimi në Universitet ose Shkollat Teknike dhe të mungesës së kohës dhe parave nga shumica e ofruesve të vegjël të shërbimeve, transferimi i dijeve mund të përdoret si një mekanizëm efektiv në mbështetjen e komuniteteve rurale për të zhvilluar turizmin me bazë komuniteti duke ofruar një mënyrë në kosto efektive të shpërndarjes së aftësive me bizneset e reja potenciale. Kjo është kritike nëse një industri e cilësisë së lartë dhe e suksesshme ekoturizmi duhet të mirëmbahet. *Koncepti i 'transferimit të dijeve' kërkon trainimin e trainuesve fillimisht dhe parashikohet që të mund të realizohet ky proces të kërkohe ndihmë nga agjencitë donatore.* 'Trainuesit' vendas nevojiten të identifikohen në komunitet nga personeli i Parkut Kombëtar dhe nëpërmjet OJF-ve të interesuara me bazë social / mjedisore të cilët do të dëshironin të mbështesnin procesin në vazhdim.

Këshilli Bashkiak i Orikumit gjithashtu ka një përgjegjësi për të qenë 'pika e parë e kontaktit' për popullsinë vendase që kërkon këshillë dhe të drejtojnë ata drejt personit ose agjencisë së duhur e aftë të plotësojë kërkesat e tyre. Këshilli i Orikumit duhet gjithashtu të konsiderojë krijimin e 'këshillit' ose 'grupit' të turizmit ku çështjet vendore të turizmit mund të diskutohen ndërmjet operatorëve të ndryshëm të qytetit/fshatit dhe Këshillit të Orikumit.

5.4 Nivelet Ideale të Kompetencës për Ofruesit e Shërbimeve të Lidhura me Turizmin

Tabelat e mëposhtëme japin një tregues të nivelit të kërkuar të ekspertizës për pozicione të ndryshme të përfshirë ose mundësisht të përfshirë në industrinë vendase të ekoturizmit. Tabelat demostrojnë qartas dijet e gjëra të kërkuara nga personeli. Planet e ardhëshme të trainimit duhet të jenë fleksibël me qëllim që të plotësojnë nevojat e individëve dhe ndryshimit të rrethanave.

Tabela 12: Nivelet Ideale të Kompetencës për Ofruesit e Shërbimeve të Lidhura me Turizmin

	Aftësi Biznesi	Aftësi Kompjuteri	Aftësi shtëse Gjuhe	Kujdesi nda Klientit	Shëndeti Publik	Ekspertizë Marketingu	Ndihma e Parë	Kultura vendase	Informacion mbi natyrën	Menaxhim rekreacioni	Menaxhim facilitetesh
Trainerët	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆
Stafi i Parkut Kombëtar: • Rangers • Administrata (rekreacioni) • Stafi i Qendrës së Informacionit	◆◆	◆◆ ◆◆	◆ ◆ ◆◆	◆ ◆◆ ◆◆	◆	◆◆ ◆	◆◆◆ ◆	◆ ◆◆ ◆◆◆	◆ ◆◆ ◆◆◆	◆◆◆ ◆◆◆ ◆◆◆	◆◆ ◆◆◆ ◆◆◆
Stafi i Shpëtimit Malor (proposed)			◆	◆			◆◆◆	◆	◆	◆◆	◆
Stafi Rajonal i Administratës - tourism (economic development)	◆◆◆ ◆◆◆	◆◆ ◆◆◆	◆ ◆	◆◆◆ ◆	◆◆◆ ◆	◆◆◆ ◆◆◆		◆ ◆	◆ ◆	◆◆ ◆	◆◆ ◆
Stafi i Administratës së Këshillit Lokal - tourism (economic development)	◆◆◆ ◆◆◆	◆◆ ◆◆	◆ ◆	◆◆◆ ◆	◆◆ ◆	◆◆◆ ◆◆◆		◆◆ ◆	◆◆ ◆	◆◆ ◆	◆◆ ◆
Kryeplaku	◆		◆	◆		◆	◆	◆	◆	◆	◆
Hotelierët / manaxherët	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆	◆◆◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆	◆
Ofruesit Lokalë të Akomodimit	◆◆	◆	◆◆	◆◆◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆	◆
Ofrues Shërbimesh: • Organizues pushimesh • Restorante dhe bare • Ofrues aktivitetesh – pony trekking etc. • Guida për ecjew në natyrë (walking), Guida specialist – vëzhgim zogjsh, guida kulturore etc.	◆◆◆ ◆◆	◆◆ ◆	◆◆ ◆	◆◆◆ ◆◆◆	◆◆ ◆◆	◆◆◆ ◆◆	◆ ◆	◆◆ ◆◆	◆◆ ◆◆	◆ ◆◆	◆ ◆◆
Stafi i Qendrave të Informacionit Turistik	◆	◆◆	◆◆◆	◆◆	◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆	◆
Përkthyes			◆◆◆				◆				
Studentë Universiteti / Kurse shkolle turizmi	◆◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆◆	◆◆

- ◆ Njohuri bazë
- ◆◆ Njohuri pune
- ◆◆◆ Njohuri ekspert

Aftësi Biznesi	Thelbësore për të gjithë personat në biznese ose përgjegjës për zhvillimin e ekonomik në administratat e ndryshme.	<ul style="list-style-type: none"> • Kontabilitet biznesi • Planifikim biznesi – planet e biznesit • Burimet financiare
Aftësi Kompjuteri	Aftësitë e kompjuterit janë thelbësore për trainerët dhe stafin e zhvillimit ekonomik. Përdorimi i kompjuterave në mënyrë të pashmangshme do të rritet, prezantimi i rezervimit në internet, rezervimet me anë email dhe kompjuter do të rrisin nevojën për shumë pjesmarrës që të jenë të familiarizuar me kompjuterat.	<ul style="list-style-type: none"> • word processing • spreadsheets • accounts packages • e-mail and world wide web
Aftësi Gjuhe	Aftësitë e gjuhës do të jenë të përdorshme për të gjithë personat që vihen ballë për ballë me turistët.	<ul style="list-style-type: none"> • Shqip • + një gjuhë të huaj shtesë: <ul style="list-style-type: none"> – Anglisht – Italisht – Gjermanisht – Frengjisht – Spanjisht
Kujdesi ndaj Klientit	Është e rëndësishme që të gjithë njerëzit kë kanë kontakte ballë për ballë me turistët të dinë se si të ofrojnë gjithnjë shërbim cilësor. Është e rëndësishme të kuptosh “se çfarë duan turistët” dhe preferencat kulturore të turistëve ndërkombëtarë	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesat e turistëve • Kërkesa për akomodimin • Kontakti me turistët • Aftësitë për të dëgjuar • Të zgjidhurit e problemit • Të marrurit me konfliktin
Ekspertize Marketingu	Kërkesë thelbësore për një masë të madhe të personelit. Është e rëndësishme të përdoren aftësitë më të gjëra të marketingut për të zhvilluar dhe mirëmbajtur industrinë.	<ul style="list-style-type: none"> • Metodatat e publizitetit • Të shkruarit e njoftimeve/reklamave • Menaxhimi i shërbimeve në rrjet
Shëndeti Publik	Thelbësore për bizneset janë furnizimi i ushqimit dhe /ose qumështit, pronatët / menaxherët e strukturave të akomodimit dhe rekreacionit. Standartet e ulta të higjenës do të kërcënojnë aftësinë e bizneseve dhe gjithashtu do të influencojë perceptimin e turistëve për destinacionin.	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesat mjedisore të shëndetit • Rregulloret mjedisore të shëndetit
Ndihma e Parë	Trainim për standartet e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar	Të trainuar për standartet e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar

Kultura Vendase	Të gjithë personat në industrinë e ekoturizmit duhet të kenë dije të aspekteve të ndryshme të kulturës dhe zakoneve vendase dhe të jenë të aftë për të drejtuar turistët në vendet e interesit dhe ti referohen historisë së tyre.	<ul style="list-style-type: none"> • Histori dhe kulturë • Evente lokale • Zakonet/traditat • Ndërtesat dhe monumentet • Mitet dhe legjendat • Artet dhe zedjet • Muzika tradicionale
Informacion Natyre	Të gjithë personat që punojnë në industrinë e turizmit duhet të kenë njohuri të aspekteve të ndryshme të mjedisit në të cilin ata punojnë. Autoriteti i Parkut Kombëtar duhet të publikojë dhe të1 diskutojë me popullsinë vendase rregulloret që i përkasin zonave të mbrojtura.	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi/përdorimi i florës dhe faunës vendase • Ekosistemet lokale • Historia e peisazhit përfshirë historinë kulturore • Gjeologji dhe topografia • Mjeshtëria e punimit të drurit • Rregulloret / menaxhimi i zonës së mbrojtur
Menaxhim Recreacioni	Është thelbësore që Menaxherët e Parkut Kombëtar, Ranxhers, pjestarët e Ekipit të Shpëtimit dhe pylltarët të jenë të familiarizuar me teknikat moderne të menaxhimit të rekreacionit dhe marrdhënien e tyre me mjedisin natyror.	<ul style="list-style-type: none"> • Menaxhimi i shërbimit në natyrë • Planifikimi i aktivitetit • Kërkesa për ruajtjen e shëndetit dhe sigurinë • Mjeshtëria e punimit të drurit
Menaxhim të Strukturave	Personeli që menaxhon struktura si qendrat e informacionit turistik, Qendrën e Parkut Kombëtar, muzeumet, etj, janë ballë për ballë me turistët në mënyrë të përditëshme dhe duhet të paraqesin një pamje të kënaqshme dhe të demostrojnë ekspertizë profesionale.	<ul style="list-style-type: none"> • Kujdesi ndaj klientit/kontakti me klientin • Ekspozimi dhe interpretimi • Zhvillim i menaxhimit • Kontabilitet • Marketing

Burimi: Përshtatur sipas "Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar Dajt"

6. MARRDHENIA E TURIZMIT ME CMPA KARABURUN – SAZAN

Prezenca e zonave të mbrojtura (që nënkuptojnë rezervatet natyrore, parqet kombëtare, rezervat detare, peisazhet piktoreske dhe sitet e trashëgimisë kulturore) janë asete të rëndësishme që mund të tërheqin interesin e vizitorëve atje. Duke lidhur turizmin me zonat e mbrojtura jo vetëm ofrohet një incentiv për standartet mjedisore për shërbimet dhe aktivitetet turistike por gjithashtu sigurohe kontributi i turizmit në ruajtjen e natyrës të zonave të mbrojtura nëpërmjet menaxhimit të zonave të mbrojtura.

6.1 Zonat e mbrojtura përgjatë zonës bregdetare

Park Kombëtar (Kat. II)

Divjake – Karavasta (Lushnje, Fier, Kavaje)

'Parku Kombëtar' Divjake – Karavasta përfshin pyllin bregdetar të Divjakës dhe Lagunën e Karavastasë dhe PK shtrihet ndërmjet grykëderdhjes së Lumit Shkumbin në veri dhe deltës së Lumit të Seman në jug. Plazhi i Divjakës frekuentohet nga turistët vendas për turizëm plazhi dhe pushime. Njësi akomoduese dhe restorante të kufizuara në numër ofrojnë shërbime për vizitorët.

Karaburun-Sazan (Vlore)

'Parku Kombëtar' Karaburun – Sazan është një zonë e mbrojtur detare miratuar me vendim Nr 289, datë 28.04.2010 të Këshillit të Ministrave. Sipërfaqja e përgjithëshme e 'Parkut Kombëtar' Karaburun – Sazan si një zonë e mbrojtur ekosistem detar është 12 570.82 ha. Kjo zonë e mbrojtur detare përbëhet nga dy pjesë, zona detare pranë Gadishillut të Karaburunit mbulon një zonë prej 9 848.95 ha dhe zona detare pranë ishullit të Sazanit mbulon një zonë detare prej 2 721.87 ha.

Ishulli i Sazanit karakterizohet nga një breg shkëmbor me kanione dhe shpella. Ishulli është një habitat i mrekullueshëm për gjallesat detare dhe zogjtë. Ishulli i Sazanit është zona më e izoluar dhe ku ndalohet hyrja. Më parë i përdorur për qëllime ushtarake, tani është një bazë logjistike për kontrollim e deteve.

Llogara (Vlorë)

'Parku Kombëtar' i Llogarasë ndodhet në malet bregdetar në Qafën e Llogarisë. Llogaraja është një habitat i shkëlqyer për gjallesat tokësore dhe zona është e mirënjohur në mënyrë të veçantë për popullatën e tij të zogjve. Kohët e fundit një rezort turistik është ngritur në Qafën e Llogarasë dhe një numër restorantesh dhe hotelesh të vegjël janë zhvilluar aty.

Butrinti (Sarandë)

'Parku Kombëtar' Butrinti i krijuar në vitin 2000 tani përfshin brënda kufijve të tij një zonë prej 86km². brënda 'Parku Kombëtar' Butrint ndodhet siti Arkeologjik i Butrintit; ai a shpall si Sit i Trashëgimisë Botërore në 1992. Butrinti është i vetmi 'Parku Kombëtar' në Shqipëri i cili ka një administratë menaxhimi dhe menaxhohet siç duhet.

Pranë 'Parkut Kombëtar' Butrinti ndodhet fshati i Ksamilit i cili i ka kapërcyer kufijtë e tij të mëprashëm fizik dhe popullsinë për shkak të zhvillimeve të pakontrolluara. Një numër hotelesh dhe restorantesh të vegjël janë zhvilluara gjithashtu, duke ju shërbyer turistëve. Ksamili frekuentohet nga turistë vendas dhe rajonalë për turizmin e plazhit dhe pushim.

Rezervatet e Menaxhuara Natyrore (Kat. IV)

Kune-Vain-Tale (Lezhë)

Ky rezervat i menaxhuar natyror përbëhet nga lagunat e Kune dhe Vain dhe ligatinat e shtrira nga Shëngjini deri Lumin Mat. Lumi i Drinit kalon përmes dy lagunave dhe një pyll pishe i kultivuar shtrihet përgjatë bregut të detit duke krijuar një habitat të pasur specimesh.

Zona mbrapa rezervatit Kune-Vain-Tale po përjeton një zhvillim të presionit ndërtimor. Gjithashtu, zona e qytetit të Shëngjinit është zgjeruar me godina apartamentedh dhe hotelesh të rinj në drejtim të zonës së mbrojtur, bazuar në planin e zgjerimit urban.

Plazhi i Shëngjinit frekuentohet nga turistë vendas dhe rajonalë për turizmin e plazhit dhe pushime. Shëngjini është destinacioni kryesor i turistëve nga Kosova.

Patok-Fushë Kuqe-Ishem (Kurbini)

Kjo zonë e mbrojtur kufizohet ndërmjet dy lumenjve, atij të Matit dhe Ishmit. Aktivitetet e turizmit janë të limituara në këtë zonë dhe vetëm disa restorante janë zhvilluar në Lagunën e Patokut.

Zona mbrapa rezervatit po përjeton një zhvillim të presionit ndërtimor.

Rrushkull (Durrës)

Kjo zonë e mbrojtur ndodhet në veri të Lumit Erzen dhe ndërmjet lumit dhe Gjirit të Lalzit.

Gjiri i Lalzit është një zonë potenciale për zhvillimin e turizmit. Një pyllë pishe mbulon brezin mbrapa plazhit të gjërë prej rëre. Disa zhvillime ndërtimesh të pasurive të paluajtshme janë bërë aty, ndërsa një investim i madh të pasurive të paluajtshme nga Dubai ka marrë miratimin për ngritjen e një kompleksi rezidencial dhe hotelier.

Plazhi, pothuajse 4km i gjatë, përdoret për banja dielli dhe pushim për pushues ditorë kryesisht nga Tirana dhe zona përreth.

Pishë Poro (Fier)

Zona e mbrojtur Pishë Poro prej pylli pishe (Rezervat i Menaxhur Natyror) shtrihet në veri të deltës së Lumit Vjosa.

Karaburun (Vlorë)

Gadishulli i Karaburunit është i një cilësie të jashtëzakonshme piktoreske. Profili bregdetar karakterizohet kanione dhe shpella mahnitëse dhe disa plazhe si xhepa të arritshëm vetëm me anije. Peisazhi nënujor është gjithashtu i një cilësie të jashtëzakonshme, me shkëmbinj, guva nënujore, me florën dhe faunën shoqëruese dhe në disa pjesë më site të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore.

Peisazh i Mbrojtur (Kat. V)

Lumi Buna-Velipojë (Shkodër)

Zonat më atraktive për qëllime turizmi janë zona e Velipojës, Laguna e Vilunit dhe Mali i Rencit. Zona e Velipojës ndërsa është një potencial për zhvillimin e turizmit të plazhit, është përballur me zhvillime kaotike dhe ndërtime të paligjshme banesash, hotelesh dhe restorantesh. Një studim urbanistik i kohëve të fundit për zonën e zhvilluar ka përmirësuar parametrat urban si hapsira e lirë urbane dhe shëtitore, zona tregtare me dyqane, kafene dhe një zyrë e informacionit turistik, hapje rrugësh, ndriçim dhe grumbullim i plehrave.

Zhvillime të reja të pasurive të paluajtshme janë në proces për momentin në zonë. Zona e plazhit të Velipojës është rekreacioni kryesor për zonën. Ai tërheq turistë vendas dhe rajonalë (nga Kosova). Një plazh i ri pushimi është hapur pranë fshatit Rrjoll, një zonë për pushues ditorë. Ky plazh ndodhet ndërmjet Lagunës së Vilunit dhe plazhit të njohur me emrin 'Rana e hedhun'.

Vjosë-Nartë (Vlorë)

Zona e mbrojtur Vjosë-Nartë mbulon territoret nga grykëderdhja e Lumit Vjosa në veri deri tek zona industriale e Vlorës së jug. Kjo zonë e mbrojtur përfshin pyllin e pishave të Pishë Poro dhe Lagunën e Nartës.

Plazhi, në jug të lagunës së Nartës, përdoret për banja dielli dhe pushim ditor kryesisht për banorët nga qyteti i Vlorës dhe zonat përreth.

6.2 Konteksti i tanishëm i Zonës së Mbrojtur Karaburun - Sazan

Duke ju referuar gjendjes aktuale të statusit mbrojtës të zonës, situata është si më poshtë:

- Zona e Mbrojtur Detare Bregdetare Karaburun – Sazan (Kat. II sipas kategorizimit të zonave të mbrojtura të IUCN-së);
- Rezervat Natyror i Menaxhuar Rrëza e Kanalit – gadishulli i Karaburunit (Kat. IV sipas kategorizimit të zonave të mbrojtura të IUCN-së);
- Parku Kombëtar i Llogarasë (Kat. II sipas kategorizimit të zonave të mbrojtura të IUCN-së);
- Gjithashtu, ka një numër monumentesh natyrore dhe kulturore me status ligjor mbënda kësaj zone.

Zona e mbrojtur Karaburun – Sazan përfshin statusin e mëposhtëm:

'Parku Kombëtar' Karaburun – Sazan është një zonë e mbrojtur bregdetare miratuar me VKM Nr 289, datë 28.04.2010. Ai përbëhet nga nga dy pjesë, pjesë detare pranë gadishullit të Karaburunit dhe pjesa detare pranë Ishullit të Sazanit.

Harta 1 (fragment nga Rrjeti i Zoave të Mbrojtura)



Burimi: MMPAU

Legjenda:

- 7 – Parku Kombëtar Llogara
- 29 – Rezervati I Menaxhuar Natyror
- 54 – ZMDB Karaburun – Sazan

Zona e Mbrojtur 'Llogara-Karaburun' (hapësira tokësore) përbëhet nga Rezervati I Menaxhuar Natyror i Karaburunit (Kat. IV e IUCN) dhe 'Parku Kombëtar' Llogara (Kat. II e IUCN).

Zona Llogara-Karaburun është e një cilësie të jashtëzakonshme piktoreske. Meqenëse 'Parku Kombëtar' Llogara është mbi kreshtën më të lartë, ai ka një bashkim pamor me detin direkt si nga jugu dhe mbi Gadishullin e Karaburunit në perëndim. Profili bregdetar karakterizohet nga kanione dhe shpella mahnitëse dhe disa plazhe si xhepa të arritshëm vetëm me anije. Peisazhi nënujor është gjithashtu i një cilësie të jashtëzakonshme, me shkëmbinj, guva nënujore, me florën dhe faunën shoqëruese dhe në disa pjesë më site të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore.

Zona e Karaburunit ka mirëmbajtur gjendjen e tij natyrore për shkak të ndalimit të hyrjes në të sepse një pjesë e tij është ende një zonë e mbyllur ushtarake nga prezenca e bazës ushtarake në 'Pasha Liman', e cila kufizon aksesin publik në zonën e mbrojtur. Gjiri i Gramës ka guva me mbishkrime dhe e gjithë seria e shpellave që gjinden aty kanë legjenda që lidhen me to. Një gurorë e lashtë mermeri gjendet në vend aty. Këto vende mund të arrihen vetëm me anë të detit. Në pjesën më të madhe të zonës nuk mund të hyhet për shkak të kufizimit ushtarak në zonë.

Menaxhimi i 'Parkut Kombëtar' Karaburun – Sazan bëhet nga administrata e parkut nën Drejtorinë e Shërbimit Pyjor të Vlorës e cila është përgjegjëse për menaxhimin e zonës së mbrojtur.

6.3 Aktiviteti Ekonomik i zonës

Komuna e Orikut numëron rreth 11,000 banorë që jetojnë në Orikum (qytet) dhe në tre fshatrat e Dukat Fshat, Dukat i Ri dhe Tragjas. Punët kryesore në zonën e komunës së Orikut janë në sektorë si rritja e blegtorisë, bujqësisë (vreshta, hortikulturë, agrume), turizëm (hotele, bare dhe restorante), grumbullim i bimëve medicinale dhe çajit, tregtisë. Tradicionalisht aktiviteti kryesor ekonomik në territorin e komunës së Orikut ka qenë rritja e bagëtive. Gjithashtu, katër baxho zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën e produkteve të bylmetit. Dërgesat e emigrantëve luajnë një rol të rëndësishëm në jetën ekonomike të familjeve në këtë zonë. Emigracioni (sidomos në Itali) është një fenomen në territorin e komunës së Orikut.

6.4 Konteksti i Potencialit Turistik në gjirin e Orikut dhe të Vlorës

Plazhet e Orikut dhe Radhimës janë të frekuentuara nga turistët vendas dhe rajonalë për turizmin e plazhit dhe rekreacion, i cili është dhe lloji kryesor i turizmit në këtë zonë. Aktiviteti kryesor për pushuesit janë banjat e diellit dhe të detit. Të dhënat për ardhjet e turistëve në gjirin e Vlorës për pushime verore mungojnë. Pjesa dominuese e klientelës janë shqiptarë rezidentë, emigrantë dhe shqiptarë të Kosovës në emigracion.

Mungon oferta e sporteve ujore në det, si dhe mundësitë për eskursione si me anije në det. Nuk ka asnjë operator vendas që të ofrojë eskursione në zonat pranë, për të vizituar atraksione natyrore apo kulturore, si dhe në zonën e mbrojtur. Eskursione individuale organizohen në Llogara me synim shijimin e ushqimit në restorantet aty; më karakteristiku është mishi i pjekur i qingjit.

Duke marrë parasysh okupimin pothuajse të plotë të kapaciteteve të strukturave akomoduese të rregjistruara si dhe të një numëri të konsiderueshëm dhomash private dhe apartamentesh të ofruara në treg në sezonin veror dy mujor, ka vend që operatorët turistikë vendas të ofrojnë eskursione ditore si në brendësi të vendit ashtu dhe në det për pushuesit.

Kërkesa për ture me varka në det mund të rritet sapo që moratoriumi i detit do të ç'fuqizohet. Gjithsesi, një pengesë në këtë drejtim për momentin paraqet çmimi për person (20 \$US) për të kryer një shëtitje me varkë dhe cilësia dhe siguria e varkave të përshtatëshme që përdoren për këtë qëllim. Ndërsa zhytjet janë një sport që kryesisht tërheq të huajt dhe ende një sport jo me shume entuziastë ndër turistët vendas.

Megjithëse turizmi ofron potencial të mirë për familjet vendase, aktiviteti i tanishëm është përqëndruar vetëm në strukturat komerciale të akomodimit (hotele dhe struktura të ngjashme) dhe restorante dhe dhënie të dhomave me qera nga vendasit gjatë sezonit veror, dhe kështu, duke neglizhuar mundësitë e mëdha që ofron Zona e Mbrojtur në zhvillimin e ekoturizmit dhe turizmit rural në zonë. Një gjë e tillë gjithashtu do të sillte dhe shtrirje të sezonalitetit dhe një shpërndarje më të gjërë të të ardhurave në popullsinë vendase.

Atraksionet kulturore dhe natyrore

Të dhënat historike dhe trashëgimia kulturore provojnë se zona e Vlorës ka një nga më të begata të bregdetit Shqiptar. Qytete si Amantia (Plloca), Olimpia (Mavrova), Oriku (Orikum), Kionina (Kaninë) dhe Aulona në Vlorën e sotme janë provë e kësaj. Gjenden një numër monumentesh kulturore nga Vlora në Orikum, ndërmjet të cilave mund të përmenden:

- qyteti antik i Amanias (shek. V B.C.), një qendër arkeologjike e ndodhur pranë fshatit Pllaçë;
- kalaja e Kaninës (shek. IV-VI B.C., e vendosur mbi kodër, si një ballkon 600 m mbi nivelin e detit, me një pamje mahnitëse mbi gjirin e Vlorës;

- kalaja e Triportit dhe muri antik nënujor (shek. IV B.C.);
- kisha Bizantine e Shën Mërisë në Zvërnec dhe Manastiri i shek. të 14-të;
- xhamija Plumbit dhe xhamia Muradia në Vlorë;
- kisha e Marmiro në Orikum;
- kulla e Abas Aliut;
- kalaja e Gjon Boçarit e ndodhur në fshatin Tragjas dhe
- rrënojat e fshatit Tragjas i vjetër.

Harta 2: Monumentet e natyrës dhe Kulturës (Zona e Orikut)



Cultural and Natural Monument Sites Map

Burimi: ICDS for the Southern Coast of Albania - Orikum Area Inventory and Assessment

Gjithashtu ka një numër shpeshash, ndërtesash, kullash dhe urash që formojnë një sistem të rëndësishëm të domethënies historike. Parku Kombëtar i Llogarasë, dhe pylli i përzier, në qafën e Llogarasë, përfshin një Monument Kombëtar Natyre në individualitetin e saj atë të "Pishës Flamur".

Pranë hyrjes së zonës ushtarake ndodhet Parku Arkeologjik i Orikut, një sit ky i trashëgimisë kulturore të një rëndësie dhe interesi kombëtar dhe ndërkombëtar. Qyteti antik i Orikut i shek 5-të, BC, ka qenë një port i rëndësishëm në zonën e Adriatikut. Në periudhën e pushtimit Turk ai quhej Pasha Liman. Orikumi shtrihej mbi kodër, pothuaj i rrethuar nga uji. Faktet arkeologjike tregojnë se Orikumi ishte një qendër e zhvilluar urbane. I fundosur nën Lagunen e Orikut, rrjeti rrugor i qytetit mund të shikohet edhe sot. ancient Ndërmjet gjetjeve të rëndësishme arkeologjike në këtë zonë mund të përmendet një amfiteater i vogël i shekullit I, i cili mund të mbante rreth 400 spektatorë. Më vonë ai u bë një port i rëndësishëm turk (Pasha Limani). Gjiri i

detit ka struktura arkeologjike siç përmban edhe qyteti antik i Orikumit. Zona është e aksesueshme nëpërmjet bazës ushtarake. Parku arkeologjik menaxhohet nga administrata e parkut e cila është nën Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Në pjesën mbrapa sitit arkeologjik dhe ngjitur me zonen e ndaluar ushtarake ndodhet Laguna e Orikumit. Laguna e Orikumit zen pjesën më të ulët të një fushe me pjerrësi të lehtë. Për shkak të nivelit të ulët të shkëmbimit të ujit me detin i tërë ekosistemi ka pësuar një ndryshim të theksuar të rregjimit të shkëmbimit të ujit. Pylli i mëparshëm është zhdukur tashmë.

The coastal shoreline along the Grama Bay area has cultural heritage sites of significant value including: sculpted frescoes from early Christian period, inscriptions from Hellenistic period, and the Gama Bay ancient quarries and inscriptions.



Fotot sipër: Mbishkrimet e Gjirit të Gramës; Fotot poshtë: Gjiri i Gramës në pjesën perëndimore të Karaburunit

Zejet dhe Traditat

Gratë e fshatrave të zonës janë të njohura për prodhime e tyre në tezgjah. Ato prodhojnë qilima dhe mbulesa leshi me motive vendase për të mbuluar divane dhe përdorime të tjera.



Zona është e njohur për gatimin e pjatave tradicionale të tilla si mish i pjekur në hell, harapash, byrek, ëmbëlsira, etj..



Kënga tradicionale e zonës është e njohur si 'polifonia'. Këngët polifonike janë këngë të vjetra folklorike të pashkruara, të trashëguara dhe të transmetuara nga një gjeneracion në tjetrin. Kjo këngë këndohet nga një këngëtar kryesor i cili shoqërohet nga një grup i përbërë nga 4-6 veta. 'Isopolifonia labe' është shpallur Trashëgimi Botërore nga UNESCO. Gjithashtu, vallja tradicionale është karakteristike për zonën e Vlorës.

Strukturat turistike

Zona turistike bregdetare shtrihet nga gjiri i Orikumit deri në Vlorë, duke përfshirë gjithashtu gjirin e Radhimës. Rreth 75 struktura akomoduese të regjistruara me një kapacitet prej 1360 dhoma me 3530 shtretër ofrojnë strehim për vizitorët nga Vlora deri në Llogara. Nga këto, vetëm në zonën e Radhime-Orikum ka 36 struktura akomodimi me një kapacitet shtretëror prej 1820 shtretërorësh. Gjithashtu, ndonëse nuk ka të dhëna për dhomat private të ofruara, rezulton se ka një numër të konsiderueshëm dhomash të vlefshme të pa deklaruara të lëshuara me qera që veprojnë në tregun informal. Ndonëse pothuajse të gjithë hotelet ofrojnë shërbim bari dhe restoranti/piceri, gjithashtu, në zonën Radhime – Orikum ndodhen rreth 13 restorante. Në restorantet tradicionale mbizotëron qingji i pjekur, gjithashtu dhe pjata të tjera karakteristike të zonës. Një listë e strukturave akomoduese dhe restoranteve jepet në Aneksin 1.

Marina Orikum

Marina Orikum, e zhvilluar në gjirin e Orikumit ofron lehtësira dhe ankorim për jahte. Në vitin 2004 është hapur faza e parë e basenit të marinës, basen i cili ka një kapacitet mbajtjeje të përgjithshëm përfundimtar rreth 600 jahte dhe varka të madhësive të ndryshme. Marina ofron të gjitha shërbimet e nevojshme përfshirë furnizim me energji elektrike, ujë dhe karburant si dhe asistencë të specializuar. Gjithashtu, ofrohet dhe akomodim në apartamente të madhësive të ndryshme. Deri tani ajo ka pritur vetëm anije dhe jahte me flamur të huaj. Për shkak të moratoriumit anijet me flamur shqiptar nuk janë lejuar në det. Ndonëse moratoriumi ka penguar anijet e argëtimit me flamur shqiptar në aktivitete detare, një numër garash me varka janë organizuar nga marina Orikum në bashkëpunim dhe me pjesmarrjen e jahteve nga Italia.

Moratoriumi i detit

Për shkak të regjimit të kufizuar për të hyrë në zonën tokësore të Karaburunit si një zonë e mbyllur ushtarake dhe në zonën detare të Karaburunit dhe Sazanit nga deti, si pasojë e zbatimit të moratoriumit detar të anijeve dhe jahteve, aktivitetet e turizmit dhe argëtimit në zonën e MCPA Karaburun-Sazan kanë qenë shumë të kufizuara.


Ekskursionet me varkë

Duke qenë se regjimi i moratoriumit është dobësuar paksa gjatë vitit 2012, disa udhëtime ekskursion me anije janë ndërmarrë nga një numër shumë i kufizuar operatorësh. Varkat dërgonin njerëz për një ekskursion gjysmë ditor në disa plazhe të vogla të Karaburunit për

banjo deti dhe dielli ose vetëm për një udhëtim në det dhe të shijonin pamjen nga deti të shpellës së Haxhi Alisë dhe peisazhin shkëmbor të Karaburunit. Ekskursionet nuk janë të organizuar në bazë të një aktiviteti të liçencuar për turizëm dhe rekreacion.

Asnjë operator turistik nuk ofron ndonjë tur me anije në gjirin e Vlorës dhe në zonën e MCPA Karaburun - Sazan. Meqenëse aktiviteti ka qenë ndaluar nga moratoriumi, nuk janë dhënë liçenca për këtë qëllim për kompanitë që operojnë anije për ekskursionet. Gjithashtu, nuk ka ture ose ekskursionet me guidë të organizuara nga banorët vendas.

Harta 3: Territori i Bashkisë Orikum



Operatorët e zhytjes

Ka një numër të kufizuar operatorësh zhytjeje që ofrojnë zhytje në ujërat e Karaburunit, por aktiviteti nuk është ende i rregulluar në bazë të vendeve të lejuara, ku aktiviteti i zhytjeve mund të kryhet. Gjithashtu, aktiviteti i zhytjeve nga këto operatorë është përballur me vështirësi të nga moratoriumi i detit. Në vazhdim jepet një listë e subjekteve dhe individëve të cilët ofrojnë shërbime të zhytjes dhe aktivitete.

1. Subjekte që ofrojnë zhytje


Subjekti	Emri i personit	Kontakti	Shenim
Blue Oasis	Enton Mishtaku	0694327605 blue_oasi@yahoo.it	Provides diving and equipments
Ekspedita Blu	Pajtim Shpata	0694646951	Provides diving and equipments

2. Individe me eksperience:

Emri i personit	Kontakti	Shenim
Fatmir Mecaj	0692441305	Offers fishing boat for free
Lace Hila	067 205 2257	Experienced diver and instructor

6.5 Urban and tourism development

Pranë zonës së lagunës ndodhet qendra urbane e Orikumit e cila po zgjerohet me zhvillimet e reja pallatesh banimi. Plani i ri rregullues Urbanistik parashikon zhvillimin e zonës urbane drejt tokave pranë ligatinave.



Map 4 Zoona e Planit të ri Urbanistik të Orikumit

Ndërtime të pasurive të patundshme të natyrës turistike po zhvillohen pranë Marinës Orikum dhe në zonën ngjitur me të, sipas një plani të zhvillimit të turizmit. Ndërsa, ndërtime sporadike të reja po bëhen në fshatrat pranë Orikumit. Zhvillimet e reja në qytetin e Orikumit të karakterizuara nga kapaciteti i lartë i përdorimit të tokës me ndërtesa prej shtatë katesh, si dhe zhvillimet e pasurive të patundshme në afërsi të Marinës Orikum, rrezikojnë të ndikojnë rritjen e presionit mbi zhvillimin e tokës. Pronarët vendas të tokës, të tërhequr nga interesat e larta të zhvillimit të tokës për qëllime të ndërtimit të pasurive të patundshme, do të ushtrojnë presion për të kthyer tokën e tyre nga përdorimi për qëllime bujqësore në tokë për ndërtim.

6.6 Konfliktet e mundshme me aktivitetet e tashme

Shkaku më i madh kryesor i kërcënimeve ndaj zonës së Orikumit dhe ujrave të tije detare (si edhe në bregdetin tjetër shqiptar) të cilat mund të rrezikojnë zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit mund të përmenden:

- zhvillimi i pakontrolluar praktikisht i tokës dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore.
- hotelet, restorantet dhe shtëpitë janë ndërtuar në zonat bregdetare pa shmangur as mjediset e ndjeshme dhe as me ndonjë mënyrë për të trajtuar ujërat e zeza ose kontrollin e mbetjeve të ngurta.
- dëmtimi i bregdet nga ndërtimet e paligjshme si hedhja e mbetjeve të gërmuara në të për ndërtimin e pontileve
- peshkimi ilegal nga dinamiti

- djegie e pemëve dhe barit në Karaburun nga barinjët

6.7 Aktivitetet / produktet e mundëshme ekoturistike në konsideratë

Karakteristikat kryesore të tipeve të turizmit, me referencë në MCPA Karaburun-Sazan janë të përshkuara në Kapitullin 1.

E tërë zona e mbrojtur Karaburun - Sazan, të dy zonat e mbrojtura, ajo tokësore dhe detare, ofrojnë mundësi të mira për zhvillimin e ekoturizmit, por deri tani nuk ka fare përdorim të këtyre mundësive për shkak të kufizimeve të ushtrisë dhe të moratoriumit në zonën e Gadishullit të Karaburunit dhe Lagunës së Orikutit. Kur menaxhohet siç duhet, turizmi mund të sigurojë të ardhura të rëndësishme për Zonën e Mbrojtur Detare Bregdetare Karaburun - Sazan. Kjo mund të jetë e vlefshme për aktivitete si zhytje me pajisje, snorkelling, vëzhgim i shpendëve, etj.

Udhëtime me anije nga Orikumi dhe Radhima për të vizituar atraksionet natyrore dhe të kulturës të gadishullit të Karaburunit (mbishkrimet e shpellës dhe gjirit të Gramës) mund të ofrohen për vizitorët, si edhe ekskursione në plazhet për banja. Nënui i Karaburunit ofron mundësi të mira për zhytje. Gjithashtu, pajisje zhytjeje dhe të snorkelling mund të vihen në dispozicion të njerëzve të apasionuar për këto aktivitete. Ka një numër të kufizuar të operatorëve të zhytjeve në këtë zonë që ofrojnë shërbime dhe pajisje.

Zhvillimi i shtigjeve për hiking dhe trekking për ecjen në këmbë në zonën e mbrojtur të Karaburunit mund të krijojë një rrjet interesant shtigjesh me shtigjet e tjera për hecje në këmbë (hiking) dhe trekking dhe lëvizje me kafshë përgjatë vendit si duke përdorur shtigjet e vjetra që lidhnin Orikumin, Tragjasin e Vletër, Dukatin e Vjetër dhe Palasën.

Laguna e Orikutit ofron mundësinë e krijimit të një vendi pushimi për vëzhgimin e zogjve dhe gjallesave si pjesë e rrugës bregdetare të hiking i cili do të vazhdonte për në gadishullin e Karaburunit. Një zgjidhje aksesi për në Parkun Arkeologjik të Orikutit dhe në zonën e mbrojtur të Karaburunit, të pa kufizuar nga baza ushtarake, do të lehtësonte aksesin publik dhe vizitat në zonën e mbrojtur.

Kutia 6: Aktivitete turistike pushimi në zonat e mbrojtura

- detare: peshkimi sportiv, varkat me vela, not, snorkelling, zhytje, kanoe, banja dielli, shëtitje me anije, ture të natyrës dhe arkeologjike.
- ligatina / tokësore: trekking – hiking, ngarje biçikleta dhe kuaj me samar, ture natyrorë – vëzhgim zogjsh, piknik, kamping.

Potenciali për turizmin duhet të shihet duke marrë parasysh të gjithë zonën e mbrojtur (zona tokësore dhe detare) dhe territoret përreth të fshatrave aty pranë. Zhvillimi i turizmit në zonat rurale duhet të jetë në formën e eko-turizmit, turizmi me bazë në komunitet dhe turizmi rural p.sh. turizmi në shkallë të vogël, i cili vështirë se do të ketë ose nuk ka fare ndikime negative në mjedis dhe i cili do të sigurojë të ardhura për banorët vendas të zonës. Mundësitë përfshijnë aktivitete si shtrat dhe mëngjes, trekking, ngarja e kuajve me samar, bare dhe restorante, hotele, kampingje, etj. Organizimi i fshatarëve në aktivitete eko-turizmi që mund të fillonin në shkallë të vogël, të tilla si duke ofruar shtrat dhe mëngjes, turet e trekking të drejtuar nga guida lokale, të jetuarit në fermat tradicionale, shitja e produkteve artizanale, etj.

Duke iu referuar potencialit nënujor të Karaburunit dhe Sazanit për vendet e zhytjeve¹⁸ me interes për turistët, zona e mbrojtura detare ofron mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit të zhytjes. Kriteret e mëposhtme janë thelbësore për zhvillimin e turizmit të zhytjes¹⁹:

- Zhytje piktoreske dhe zhytje të mira alternative nëse koha priset;

¹⁸ Michael. C. Upton, 2006. A diving survey of the Albanian coast between Saranda and Vlora to asses the potential for diving tourism

¹⁹ Ibid

- Një mundësi zgjedhjeje e madhe zhytjesh, kështu që asnjë zhytje nuk përsëritet p.sh. në një pushim një javor zhytjeje;
- Anije të rehatshme të përshtatshme për shëtitje në det, mjaft të shpejta për të arritur shpejt në vendet e zhytjes;
- Mbështetje të plotë sigurie në barkë dhe në breg, duke përfshirë pajisjet e ndihmës së shpejtë, ato të shpëtimit në det dhe transferimin e shpejtë në një spital me pajisje të dekompresimit, meqenëse Turizmi i Zhytjeve nuk zhvillohet pa aksidentet e zhytjes;
- Akomodim të rehatshëm dhe ushqim të mirë;
- Rregullore të zbatuara në mënyrë rigoroze për të siguruar që standardet e sigurisë plotësohen;
- Akses i lehtë për në vendin e destinacionit me një kohë të shkurtër udhëtimi (nën 5-6 orë) dhe një minimum lidhjesh, nga vendet origjinë.

Kritere të tjera të rëndësishme janë:

- Një mundësi zgjedhjeje të madhe të operatorëve të zhytjeve që ofrojnë trajnime zhytjeje në gjuhë të ndryshme dhe ekskursione interesante;
- Aktivitete pas zhytjeve ku zhytësit mund të bisedojnë dhe të gëzojnë mbrëmjet së bashku.

Kutia 7: Turizmi i Zhytjes me pajisje:

- Përkufizim: Udhëtime turistike për të cilat qëllimi kryesor është zhytja me pajisje. Kjo përfshin zhytjen në ujëra të ëmbla, si dhe në det, por përjashton të gjitha llojet e snorkelling. Pajisje specialistësh kërkohen (më së shumti një cilindër zhytjeje dhe rregullator), por kostume të lagësht (ose të thatë) zakonisht vishen për ngrohtësi dhe mbrojtje. Ndërsa nuk është e domosdoshme që të kesh kaluar një kualifikim zhytjeje për t'u zhytur, pjesa më e madhe e operatorëve komercialë do të marrin vetëm klientët që kanë një formë të vlefshme të certifikatës, e cila tregon se ata kanë arritur një nivel të caktuar kompetence. Përndryshe ato ofrojnë trajnime për të arritur këtë certifikatë.
- Qendrat e Zhytjes ofrojnë të gjitha ofertat e nevojshme si anije, pajisje zhytjeje, guida të shytjeve dhe instruktorë, mirëmbajtje, dhoma për kurset e trajnimit dhe bare dhe kafene për ndërveprim social

Drejtimi i zhvillimit të produkteve turistike

Parimet udhëzuese në vijim duhet të respektohen në të ardhmen, kur numri i vizitorëve të rritet në një numër të kënaqshëm:

- Produktet turistike të zhvilluara brënda ZM duhet të jenë të përshtatshme me vlerat dhe qëllimin për të cilën ZM është krijuar dhe nuk duhet të kërcënojë biodiversitetin apo funksionin ekologjik të saj.
- Në zhvillimin e produkteve turistike, VNM dhe kërkesat për autorizim mjedisor duhet të konsiderohen dhe të respektohen.
- produktet e turistike duhet të përcaktohen për të përfituar nga bukuria dhe karakteristikat unike të biodiversitetit të ZM.
- produktet e turistike duhet të zhvillohen në përgjigje të kërkesave të tregut të turizmit dhe mundësitë brenda ZM dhe duhet të vlerësohen me kujdes për të përcaktuar zbatueshmërinë e tyre.
- zhvillimi i produkteve turistike brenda ZM duhet të integrohet me strategjitë dhe planet e turizmit në rajon.
- Turizmi duhet të përdoret si një mjet për gjenerimin e aktivitetit ekonomik dhe punësimit në komunitetet brenda dhe përreth ZM.

6.8 Aktivitetet e Pushimit dhe Turistike brënda ZM

Zona tokësore e ZM (Karaburuni dhe Laguna e Orikumit) mund të ofrojnë një gamë të gjërë të mundësive të edukimit, pushimit në natyrë dhe shërbimeve të lidhura në një mënyrë që respekton funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike dhe peisazhet natyrore / kulturore.

6.8.1 Aktivitetet në Zonat Natyrore të Pushimit

Aksesi i pakufizuar për ecje në natyrë, hiking, çiklizëm, ngarje kali me samar, alpinizëm, vëzhgim zogjsh dhe aktivitete të tjera ekologjike dhe pushime me bazë natyrën, në përputhje me rekomandimin e Planit të Menaxhimit, duhet të garantohet nga heqja e regjimit të kufizuar të aksesit në zonë nga prania e bazës ushtarake. Mund të zhvillohen shtigje për ecje të vetë-orientuar dhe biçikleta malore, shtigje trekking dhe shtigje për ngarje kuajsh me samar.

Inkurajohen zhvillimet e turizmit me bazë komunitetin, të tilla si shtëpi-për qëndrim dhe shndërrimi i objekteve ekzistuese tradicionale si akomodim turistik në fshatrat e zonës. Kampingje për të kaluar natën do të lejohen në zonat e përcaktuara sipas rregullave të caktuara.

Gjendja e dëshiruar: Peisazhe natyrore, pothuaj-natyrore ose të menaxhuara, të cilat menaxhohen kryesisht për të promovuar objektivat rekreative dhe edukative. Theksi kryesor është në aktivitete rekreative të cilat janë më të sigurta për cilësinë e shërbimeve të ofruara sesa në një Zonë Ruajtje. Nga natyra e tyre, këto zona janë vendosur në peisazhe më të transformuara. Ndërveprimi dhe socializimi janë një pjesë integrale e eksperiencës.

Aktivitetet: Varkat e motorizuara lejohen vetëm nën kontroll të rreptë (p.sh. jo ski-ujë, kufij të ulët të shpejtësisë dhe zona pa valë deti), facilitete eko-miqësore që lehtësojnë aktivitetet ekologjikisht të qëndrueshme dhe eksperiencat e vizitori, p.sh. stola, maskime për zogj, tabela informuese, kulla vëzhgimi. Nevojitet parkimi për akses në këtë dhe zona të tjera.

Lloji i faciliteteve: ndikim i ulët – në të mesëm, facilitete eko-miqësore që lehtësojnë aktivitetet ekologjikisht të qëndrueshme dhe eksperiencat e vizitori, p.sh. stola, maskime për të vëzhguar zogj, tabela informuese, kulla vëzhgimi. Parkimi për akses hyrjeje në këtë dhe zona të tjera.

6.8.2 Aktivitetet në Zonat Aktive të Pushimit

Në zonat e Pushimit Aktiv të caktuar nga Plani i Menaxhimit (2005) në disa gjire të përshtatshme në Gadishullin e Karaburunit për të akomoduar numrat vizitorët, subjekt i lejuar sipas marrëveshjes, një numër facilitetesh mund të zhvillohen duke përfshirë, qendra interpretimi, sheshe pikniku të shërbyer në mënyrë të rregullt, parking makinash, sheshe kampingu të shërbyer, zona mini-fusha sportive jo definitive, dhe shtëpiza dhe struktura restorantesh të vogla.

Gjendja e dëshiruar: Peizazh me përdorim të lartë, të cilat menaxhohen kryesisht për të mbështetur aktivitetet e vizitorëve më shumë të varur në facilitete, në funksionet edukuese dhe administrative të rezervateve. Struktura me intensitet të lartë vizitorësh me komoditete moderne të komercializuara me aktiviteteve shumë të përqëndruara. Cilësia e eksperiencës së vizitorit është shumë e varur në cilësinë e shërbimeve të cilat mundësojnë vizitorin të përjetojë mjedisin me një minimum përpjekje. Për shkak të ndikimeve të larta këto janë të përqëndruara në nyje të veçanta. Këto nyje janë në përgjithësi të vendosura në zonat e gjireve ekzistuese me hapësirë të hapur. Fokusi kryesor i menaxhimit është për të siguruar një eksperiencë të cilësisë së lartë të vizitorit ndërsa siguron që aktivitetet kanë një ndikim minimal në mjedis rrethues dhe se burimet e trashëgimisë respektohen.

Aktivitetet: Evente, ecje individuale në natyrë, shtigje të aksesueshëm për karroca me rrota (për personat me probleme), parking, piknik, zhytje, banjo deti, zona mini-fusha sportive jo definitive, dhe shtëpiza dhe struktura restorantesh të vogla, serf me velë, surf, kayak dhe kanoe të cilat kanë ndikim të vogël mbi mjedisin natyror.

Tipi i shërbimeve: Zona pikniku, zona parkingu, restorante, qendra informacioni, dushe, struktura të edukimit mjedisor, etj.. Ofrohet parking, nga i cili akses i këmbësor nëpër shtigje dhe rrugina kap zonat e tjera.

Aktivitete rekreative të motorizuara të ndaluara: Për shembull, ski uji, anije jet, përdorimi i automjeteve me katër rrota aktive për rekreacion, anije me motor dhe motorrë uji, nuk janë të lejuara. Përdorimi rekreativ i makinave duhet gjithashtu të kufizohet, megjithëse transporti publik mund të lejohet në disa zona ku aktiviteti i motorizuar është i ndaluar.

Zona e Hiking dhe argëtimit në natyrë

Mundësi të ndryshme rekreacioni (hiking, shëtitje, not, studim natyre) mund të shikohen në mënyrë të përshtatshme me zonën dhe të përjetohen eksperiencia.

6.8.3 Fasilitetet kryesore në ZM

– Shtigjet

Shtigjet do të shënjohen, të bëhen të dukshëm ose ndërtohen dhe pajisen me rrugina të shtruara për të mundësuar që publiku t'i përdorë ato në një mot të thatë dhe për të minimizuar dëmtimet fizike dhe erozionin të shkaktuar nga përdorimi. Vëmendje do t'i kushtohet nevojave të vizitorëve me aftësi të kufizuara për t'ju mundësuar atyre që të vizitojnë qendrat e informacionit dhe gjithashtu disa nga shtigjet e natyrës.

Rekomandime për shtigjet²⁰

- Shtigjet duhet të zhvillohet si një mjet për interpretim mjedisor dhe kulturor. Atraksionet (pamje piktoreske, flora dhe fauna, etj) dhe ndjeshmëria (ndikim më i pakët) duhet të jenë faktorët kryesorë përcaktues në vendosje.
- Zhvillimi i shtegut duhet të marrë parasysh nivele të ndryshme të aftësisë për turistë të ndryshëm.
- Është më mirë për të krijuar shtigje në formë laku të mbyllur për të sjellë vizitorët përsëri në pikënisje. Kjo parandalon që vizitorët të ripërshkojnë itinerarin e tyre, duke përmirësuar kështu eksperiencën e tyre.
- Zhvillimi i shtegut duhet të përfshijnë kontrollet e erozionit, e cila është përgjegjësi e Parkut Kombëtar.
- Shtigjet duhet të jenë qartë të kufizuar, për të shkurajuar vizitorët që ti braktisin ato.

Asnjë trase e veçantë skish nuk do të mirëmbahet në park dhe asnjë pastim, mirëmbajtje ose pastrim i gjurmëve nuk do të bëhet për këtë qëllim.

– Shtigjet e Kuaive

Ngarja e kuaive lejohet në rrugët ku lejohet trafiku automobilistik. Shtigjet e kuaive nuk do të kenë ndonjë shenjim të veçantë.

– Rrugët e biçikletave

Ngarja e biçikletave është e lejuar në rrugët ku trafiku i automjeteve është i lejuar. Përveç kësaj, ajo është e lejuar në shtigje. Ngarja e biçikletave në zonat pa rrugë brenda parkut është e ndaluar.

– Rrugët

Rrugë të reja nuk do të ndërtohen. Disa rrugë duhet të përmirësohen. Disa prej rrugëve ekzistuese mund të mbyllen për makinat. Ato mund të përdoren për qëllime të mirëmbajtjes ose të kthehen për hiking, ngarje biçikletash ose shtigje kalërimi. Administrata e zonave të mbrojtura mund të caktojë kufij shpejtësie dhe përkohësisht të mbyllë rrugët sipas nevojës.

– Vendet e pushimit dhe gatimit

Qendrat dhe pikat e informacionit do të përfshijnë vende pushimi. Përveç këtyre, vendet e pushimit dhe gatimit ofrohen përgjatë rrugëve dhe shtigjeve. Stola dhe ndërtime të tjera modeste pushimi mund të vendosen përgjatë shtigjeve më të përdorura. Do të ketë vende parkimi të përshtatshme pranë të gjitha qendrave të informacionit.

– Sheshet e kampingut

Sheshet e kampingut do të kenë vende për tenda, një vatër zjarri, një strehë për lëndën djegëse, një tualet, kosh mbeturinash, shenjat e shtegut dhe një tabelë të vogël informacioni me informacionin përkatës.

– Akomodim mbrënda në ambiente

– Sipërmarrësit privatë duhet të ofrojnë kryesisht akomodim në ambiente brënda për vizitorët e parkut.

²⁰ The Nature Conservancy - Ecolodge Guidelines

6.9 Aktivitete të Veçanta Rekreative dhe Turistike – Projekt Drejtime

Aktivitet Rekreativ	Mundësi Zhvillimi / Ndikimi i Mundshëm	Kontrolle / Rekomandime
Ecje në natyrë dhe Hiking	Kjo është mënyra më popullore për gjatë gjithë vitit e cila mund të realizohet nëpër territorin e Parkut Kombëtar. Ndikimi mjedisor është i ulët përsa i takon shtresës së shtegut. Gjithsesi mbeturinat do të jenë një problem në rritje ndërsa numri i vizitorëve rritet.	Një rrjet shtigjesh të gjatësisë së shkurtër dhe të mesme duhet të identifikohen në Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar për të përcaktuar një gamë të gjerë të rrugësh. Këto duhet të jenë të gjatësive të ndryshme, mundësisht të lidhen me një shteg tjetër dhe të formojnë një 'rrjet'. Rrugët duhet të kenë shenjzime me tabela dhe qartësisht të dallueshme në terren dhe hartat rrugore të të jenë të disponueshme nga ana e Parkut Kombëtar kundrej pagesës. Nuk është normale për të vendosur koshat e mbeturinave përgjatë rrugëve të tilla, përveç se në zonat e piknikut, sheshet e kampingut dhe pikat shikimin gjatë rrugës, pra, veprimi i kodit të sjelljes duhet të zbatohet përmes mënyrave të ndryshme të publitetit dhe edukuese dhe gjithashtu duke punuar me grupet e interesit duke përdorur zonën. Mbledhja dhe largimi i mbeturinave duhet të bëhet nga Autoriteti i Parkut.
Rrëshqitje me ski në kodra dhe Snowboarding	Ky sport nuk zhvillohet në Parkun Kombëtar	Zhvillimi i strukturave të skive mund të shkaktojë dëme mjedisore. Asnjë strukturë për rrëshqitje me ski në kodra nuk duhet aprovuar brënda Zonës Qëndrore (Core) të Parkut Kombëtar Llogara.
Kanoe	Nuk ka lumej brënda Parkut Kombëtar të cilët të jenë të përshtatshëm për të zhvilluar këtë aktivitet në një farë mënyre. Kanoe kanadeze mund të zhvillohet në det.	Për sigurinë e publikut, inspektimi i pajisjeve dhe liçencave të personelit kompetent do të nevojitet të ndërmerren nga një autoritet kompetent.
Ngarja e kuajve	Zona ofron mundësi të mëdha për zhvillimin e kalërimit me kalë dhe trekking dhe kjo mund të zhvillohet në një atraksion të rëndësishëm si për vizitorët vendas dhe ata ndërkombëtare. Kalërimi i kuajve lejohet në rrugët ku lejohet trafiku i automjeteve. Sistemi i rrugëve pyjeve mund të ofrojë mundësi për të kombinuar shtigjet e kalërimit / biçikleta malore. Shpesh konfliktet mund të lindin, ku kuajt dhe personat në ecje përdorin të njëjtat shtigje, prandaj ku të jetë e përshtatshme (rrugët e ngushta) përdoruesit duhet të ndahen.	Shtigje e veçanta të kalërimit duhet të jenë të shenjzuar dallueshëm. Këto mund të kombinohen me shtigjet e biçikletave malore (shih më poshtë) Një rrjet shtigjesh duhet të zhvillohet duke lejuar kalërimi të gjata dhe të shkurtra. Shtigje të shumta mund të zhvillohet, me ndalesa gjatë natës në intervale 30km me kalërues që përdorin akomodim vendas dhe stalla të thjeshta për kuajt. Stallet duhet të zhvillohen privatisht sipas një marrëveshjeje licencimi me Autoritetin e Parkut. Një pagesë në kalë dhe kalorës duhet të bëhen në buxhetin e Parkut. Individët privatë që sjellin kuajt në park duhet të paguajnë në përputhje me përdorimin e shërbimeve të parqeve.
Biçikletat Malore	Ky është një aktivitet tejet popullor dhe ka tërheqje ndërkombëtare; Megjithatë, biçikletat malore mund të jetë një burim i madh i problemeve të erozionit në zonat kodrinore të brishta dhe do të duhet të jenë fort të kontrolluara në Parkun Kombëtar. Qiradhënia e biçikletave është bërë e mundur nga një numër i Parqesh Kombëtare Europiane, si një mjet për të fituar të ardhura. Qiradhënia private e biçikletave duhet të bëhet e mundur sipas një marrëveshjeje licencimi me Autoritetin e Parkut.	Ngarja e biçikletave lejohet në rrugët ku lejohet trafiku i automjeteve. Gjithashtu lejohet në shtigjet. Ndërsa shihet e pamundur që një ndalim i plotë i biçikletave malore do të ishte praktikë, zhvillimi i një rrjeti duhet të konsiderohet dhe aksesit të kontrollohet në mënyrë strikte nga Autoriteti Manaxheriar i Parkut për të shmangur rritjen e erozionit në zonat që janë popullore të frekuentimit. Rrjeti i shtigjeve të biçikletave mund të kombinohet me shtigjet e kuajve meqenëse një sipërfaqe e fortë e rrugës për biçikletat malore besohet e dëshitueshme. Gjurmët e përshtatshme për biçikletat malore duhet të kenë: • Një gjurmë ose rrugë me sipërfaqe të fortë guri dhe rrugë e shënuar për

		<p>biçikleta</p> <ul style="list-style-type: none"> • Maksimumi i pjerrësisë prej 25% dhe pjerrësia zotëruese prej 5 – 15% • Gjërësia e pastër 90-120 cm dhe gjërësia e gjurmës prej 30 – 60 cm <p>Ngarja e biçiklës jashtë rrugëve në park është e ndaluar dhe duhet ndalohet me rregullore dhe kur është e nevojshme, të zbatohet me detyrim.</p> <p>Edukimi i klientëve – një kod sjelljeje vullnetar duhet të vendoset. Hotelet dhe bizneset që japin me qera biçikleta duhet të informojnë marrësit me qera për rregulloren dhe arësyet se pse rregullorja është vendosur. Postera dhe tabela për kujtesë duhet të përdoren në qendrat e e dhënies me qera dhe gjithashtu është e preferueshme në tabelat e informimit të hotelit, etj..</p>
Kacavjerrjet dhe ngjitjet në mal	Ka mundësi për ngjitje në mal dhe kacavjerrje në shkëmbinj përgjatë zonës së parkut. Individë dhe antarë klubesh e zhvillojnë tashmë aktivitetin.	Ngjitjet qe janë popullore duhet të monitorohen në koordinim me klubet vendase të alpinizmit dhe ku ka dëmtim të madh të vegjetacionit shkëmbor dhe /ose dëmtim i karakteristikave gjeologjike po ndodh në rrugët e ngjitjeve të shpeshta, këto duhet të mbyllen periodikisht. Përdorimi i ndihmësave artificialë, si ganxha (pitons) dhe vida shkëmbore duhet të ndalohen sepse dëmtojnë shkëmbijtë.
Hang-gliding / Paragliding	Një sport në minoritet i cili ndërmerret në afërsi të Qafes së Llogarasë. Sporti nuk ka gjasa të bëhet një aktivitet kryesor dhe shpesh ka më shumë spektatorë sesa pjesëmarrës.	Kërkohej që pajisjet të merren me automjetet deri në majë të malit. Akses i kontrolluar duhet lejuar në zonat jo të ndjeshme ku ekziston një rrugë apo gjurmë e përshtatëshme.
Vizita në shpella	Gjeologji e pjesës më të madhe të zonës ofron mundësi për eksplorim shpellash.	Nevojitet kontroll rreth aktivitetit të vizitave në shpella për të parandaluar dëmtimet në strukturat e shpellës dhe gjithashtu në habitatet delikate. Duhet të përpilohet një rregjistër i të gjithë strukturave të shpellave të njohura dhe të jepet mbrojtje e nevojshme ku kërkohet.
Katër rrota aktive	Ngarja e makinave jashtë rrugëve dhe përdorimi i tëpruar i rrugëve jo të shtruara do të kontribuojë në problemin e erozionit të zonës. Ajo gjithashtu do të konfliktuonjë me përdorues të tjetër rekreacioni si njerëzit që ecin më këmbë, ngarësit e kuajve dhe të biçikletave. Përdorimi i ngarjes rekreative së makinave jashtë rrugë për këtë arsye konsiderohet në përputhje me krijimin e Prkut Kombëtar dhe si rezultat duhet të mos lejohet.	Ngarja rekreative e makinave me katër rrota aktive duhet ndaluar nga Administrata e Parkut Kombëtar nga ngarja jashtë rrugë.
Zhytje	Një sport në minoritet i cili mund të ndërmerret në afërsi të Karaburunit.	Zhytja, veçanërisht nëse shoqërohet me peshkim nënujor, mund të jetë një problem serioz nëse praktikohet në zonat e ndjeshme ekologjike ose ku ka përqëndrim të madh zhytësish, të cilët mund të shkaktojnë shqetësim për faunën dhe dëmtim të gjallesave ose të eliminojnë ato pak specie që ekzistojnë në disa pjesë të bregdetit dhe të pengojnë ripërtëritjen e tyre.
Zhytje me pajisje	Kjo përfshin zhytjet ne urrat e ëmbël gjithashtu dhenë det, por përjashton të gjitha llojet e zhytje msno maska me tub (snorkelling). Qendrat e zhytjes do të ofrojnë gjithshka si pajisjet, anijet, guidat e zhytjes dhe instruktorët, mirëmbajtjen, dhomat për kurse trainimi dhe baret e kafenetë për lidhje sociale.	Qendrat e zhytjes do të ofrojnë gjithshka si pajisjet, anijet, guidat e zhytjes dhe instruktorët, mirëmbajtjen, dhomat për kurse trainimi dhe baret e kafenetë për lidhje sociale. Pajisje specialisti kërkohen (në pjesën më të madhe një bombol gazi dhe rregullatori), por kostumi i laget (ose i thate) visht gjithashtu për ngrohtësi dhe mbrojtje. Ndërsa nuk është e rëndësishme të kesh kaluar një kualifikim zhytjeje për t'u zhytur, shumica e operatorëve komercialë do të marrin vetëm klientët të cilët kanë një formë të vlefshme certifikate, e cila tregon se ata kanë arritur një nivel të

		caktuar kompetence. Në mënyrë alternative ta ofrojnë tarinim për ta marrë këtë certifikatë. E rëndësishme për një sektor turistik të qëndrueshëm të zhyjes është mbrojtja e ekosistemeve detare dhe nënujore përfshirë zonat e projektuara dhe rregulloret e peshkimit në zonat e seleksionuara.
Motorrët e shpejtë të ujit dhe lundrim me anije	Sporte ujorë të përdorur për rekreacion	Motorrët e shpejtë të ujit dhe lundrimi me anije mund të çojnë në probleme mjedisore. Skitë-jet (skitë e ujit të terhequra nga skafe të fuqishëm) dhe motorrët e shpejtë të ujit gjenerojnë ndotje të konsiderueshme zhurme.

<u>Struktura Rekreacioni</u>		
Shërbimet për personat e paaftë		
Ku proktikisht është e mundur të gjitha aktivitetet e rekreacionit dhe shërbimet e Parkut Kombëtar duhet të planifikohen dhe menaxhohen me personat e paaftë në mëndje		
Struktura	Mundësia e Zhvillimit	Rekomandimi
Kamping	Sheshet e shërbyer të kampingut do të ofrohen në Zonën Aktive të Rekreacionit RZ1 Një sërë sheshesh të kampingjeve me densitet të ulët vetëm për çadra duhet të identifikohen për përdirim vizitorësh në Zonën e Përdorimit Tradicional të parkut RZ1(Zona Aktive e Rekreacionit RZ1). Sheshet e kampingut do të kenë vendet për çadrat, një vatër zjarri, një strehë për lëndën djegëse, një tualet, kosh mbeturinash, tabelat e shtegut dhe një tabelë të vogël informacioni me informacionin e duhur. Pagesat / lejet e kampingut duhet të përdoren nga Administrata e Parkut Kombëtar.	The serviced sites will include wet toilets, showers and hard road access to camping pitches. The small sites should be equipped with a clean water source, toilet facilities (dry) and waste disposal points. The Ranger Service should monitor the sites and undertake necessary maintenance as required. Waste disposal points should be cleared daily. These should preferably be located in woodland areas so as not to create a visual disturbance. Camps should accommodate 20 – 25 units maximum.
Picnicking	Struktura piknuku do të ofrohen në pika strategjike kudo në park. Lënda për zjarr për barbekue do të funrnizohet nga ana e Parkut meqenëse mbledhja vetë e saj shkakton dëmtime në pysh dhe heqje të drurëve të rrëzuar ne sipërfaqe të pyllit.	Standartet e shesheve të piknikut normalisht kërkojnë që vendi të jetë: Picnic site standards normally require that the site is: <ul style="list-style-type: none"> ▪ i ndodhur brënda distancës 100m nga sheshi i parkingut ▪ 15 – 40 njësi/ha dhe të ketë stola dhe tavolina, vatër zjarri për barbekue dhe një kosh mbeturinash. Çdo njësi mban 4-8 persona. Sheshet e piknikut në Zonën Aktive të Rekreacionit RZ1 do të kenë parking. Ku është e mundur parkingu duhet të jetë i padukshëm nga vendi i piknikut.
Shtigjet Natyrore dhe Shtigjet Kulturore	Mundësi të mëdha janë të mundëshme për të zhvilluar shtigje natyrore / kulturore. Këto lidhen më së miri me materialet interoretuese / edukative.	Shtigje natyrore / kulturore normalisht janë rrethorë në dizajn duke sjellë vizitorët përsëri në pikën nga ku ato u nisën. 1-1.5 km konsiderohet të jetë gjatësia normale dhe duhet të përmbajë një numër vendndalimesh të interesit për të qëndruar. Materialet interpretuese mund të merren ose duke përdorur një sistem tabelash ose

		<p>fletëpalosje të disponueshme nga zyrat e informacionit të Parkut Kombëtar.</p> <p>Stola dhe konstruksione të tjera modeste për pushim mund të vendosen përgjatë shtigjeve më popullore.</p> <p>Shërbimi Ranxher i Parkut Kombëtar duhet të ofrojë shtigje më të gjatë me guidë.</p>
Zonat e Lojrave për Fëmijë	<p>Loja është një pjesë e rëndësishme e çdo qëndrimi të fëmijës në fshat dhe prandaj duhet të konsiderohet në çdo plan rekreacioni. Pajisje të rregullta loje do të jenë të papërshtatëshme në shumicën e zonave të 'parkut' ku ka hapsira publike, megjithatë, mundësitë ekzistuese 'të lojës' mund të ofrohen duke përdorur materialet natyrale të gjetura në park.</p>	<p>Zonat e lojrave do të ofrohen siç dhe ku klërkohen.</p>
Qendra të Informacionit / Interpretimit të Vizitorëve	<p>Qendra kryesore e informacionit dhe interpretimit do të jetë në pikën hyrëse të PK për të dy përdoruesit, tokësore dhe detarë. Kjo ndërtesë do të përfshijë zyrat e Parkut Kombëtar. Ka mundësi të krijimit të qendrave të vogla përgjatë Parkut në të ardhmen, përfshirë pikat e informimit lokal në dyqanet dhe baret e fshatrave.</p> <p>Qendrat dhe pikat e informacionit do të përfshijnë vende pushimi.</p> <p>Përveç këtyre, vendet e pushimit ofrohen përgjatë rrugëve dhe shtigjeve në park.</p> <p>Do të ketë vende të përshtatëshme parkimi pranë të gjithë qendrave të informacionit.</p>	<p>Stendat në qendrat e vizitoprëve duhet të jenë interactive dhe moderne (jo kafshe të ballsamosura, etj.)</p> <p>Hyrja në ambientet e shërbimeve duhet të jetë pa pagesë.</p> <p>Vëmëndje do ti kushtohet nevojane të vizitorëve me të meta dhe handikap për tëu mundësuar ata të vizitojnë qendrat e informacionit dhe gjithashtu disa nga shtigjet natyrore.</p>
Maskimet e gjallesave	<p>Këto janë në avantazh kur habitatet e gjallesave janë yë përshtatëshme për t'u vëzhguar.</p> <p>Mund të nevojitet që aksesit publik të kontrollohet duke sbatuar një sistem rezervimi.</p>	<p>Maskimet nuk është e nevojshme të jenë fikse and një program ornithologistët mund të zhvillohet nga stafi i parkut Kombëtar.</p>

Burimi: Përshtatur nga "Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar Dajt"

6.10 Rekomandime për Planin e Menaxhimit

1. Komponentja e Turizmit të Planit të Menaxhimit

Me qëllim të të pasurit një Plan Menaxhimi të plotë për kompleksin e zonës së mbrojtur 'Karaburun-Rreza e Kanalit-Orikum-Tragjas-Dukat' është e nevojshme t'i shtohet atij komponenti 'Menaxhimi dhe Zhvillimi i Turizmit'. Ky komponent duhet të përfshijë të gjitha çështjet që lidhen me të (jo të gjitha çështjet janë mbuluar nga ky vëzhgim) dhe të propozojë gjithashtu një plan fizik të territorit (studim hapësinor/urbanistik) për turizmin dhe rekreacionin. Plani duhet të caktojë sheshet e përshtatëshme të rekreacionit për zhvillimin e strukturave dhe të zhvillojë një plan konceptual për këto sheshe rekreacioni në komformitet me hartën Nr 11 të Planit (shiko me poshtë pika 2) siç janë planifikuar zonat e rekreacionit. Nga pikëvështrimi turistik, një plan menaxhimi i plotë nevojitet të:

- a) Kërkojë kufij të qartë për bazën ushtarake që të lejojë aksesin dhe ushtrimin e aktiviteteve rekreative në zonën tokësore dhe detare të Karaburunit dhe Lagunën së Orikumit.
Caktimi i kufijve të zonës ushtarake është i rëndësishëm për të maksimalizuar bashkëpërdorimet dhe lejimin e operatorëve turistikë të ushtrojnë aktivitetin sipas liçencave dhe vendeve të lejuara nga autoritetet menaxhuese të Parkut sipas planit të menaxhimit.
- b) Kërkojë kufizimin e zonës së bazës ushtarake me qëllim të lejimit të aksesit të lirë a) në zonën e mbrojtur (zona tokësore e Karaburunit) për vizitorët dhe operatorët turistikë për të ushtruar aktivitetet turistike (ecje me këmbë në natyrë, hiking, etj..) dhe b) në sitin arkeologjik të Orikumit për vizitorët që duan të vizitojnë atë.
- c) Propozojë mënyrën sesi zona e mbrojtur dhe siti arkeologjik mund të kenë hyrje independente pa pasur kufizim dhe ndërhyrje nga baza ushtarake detare;
- d) Propozojë çlirimin e territorit të sitit arkeologjik (pranë kodrës së amfiteatrit) nga strukturat ushtarake. Gërmimet arkeologjike të Orikumit të lashtë, përfshirë gërmimet arkeologjike nënujore përreth mbetjeve nënujore mund të krijojnë një sit megnet të trashëgimisë kulturore për vizitorët.
- e) Propozojë përdorimin e ndërtesave ushtarake pranë sitit arkeologjik si një Qendër Informacioni dhe Interpretimi për sitin arkeologjik të Orikumit dhe të Parkut Kombëtar, krijimin e Muzeut të Luftës së Ftohtë si dhe Zyrat e Administratës së PK.
- f) Seleksionojë zonat e lejuara ku aktivitetet e rekreacionit dhe ato turistike mund të zhvillohen, a) në zonën e mbrojtur detare, të tillë si vendet e banjave të diellit, pika e hyrje së PK nga deti dhe vendi/vendet ku mund të ankorohen barkat, zonat e zhytjes me pajisje, dhe b) në zonën tokësore, të tilla si pikat e hyrjes në PK, qendra e vizitorëve, qendrat e informacionit turistik, sheshet e shërbyera të piknikut, sheshet e shërbyera të kampingut, parkinge, zonat e rekreacionit dhe të lojrave dhe strukturat e restoranteve dhe hoteleve të vegjel.

Gjithashtu, për zhvillimin e turizmit në PK nevojitet hartimi i 'Planit të Marketingut të Turizmit'.

2. Rishikimi i Planit të Menaxhimit

Duke ju referuar zonimit për qëllime rekreacioni dhe turizmi, siç jepet në hartën Nr 11 në Planin e Menaxhimit për kompleksin e zonës së mbrojtur 'Karaburun-Rreza e Kanalit-Orikum-Tragjas-Dukat' (Qershor 2005), është i nevojshëm rishikimi i këtij Plani Menaxhimi. Harta Nr 11 jepet më poshtë për referencë. Harta Nr 11 në Planin e Menaxhimit (2005) ka nevojë për përpunim të mëtejshëm dhe zonim të detajuar sepse:

- Zonimi për qëllime rekreacioni dhe turizmi, dhënë në hartën Nr 11, nuk përkon me Përshkrimet Menaxhuese të Zonës të ZM të dhëna në të njëjtin dokument tek "Kutia 6 - Përshkrimet Menaxhuese të Zonës të ZM".

ZR1 - Zonë Aktive Rekreacioni, në Përshkrimet Menaxhuese të Zonës ndërsa jepet referencë për shërbimet ekzistuese të rekreacionit në PK Llogara, në hartën 11 zona aktive nuk jepet grafikisht. ZR1 për PK Llogara duhet të reflektohet grafikisht në hartë.

Në hartën nr 11 zonat e identifikuar Recreacion Natyror / Zonë Turistike (shkronja D2) duhet të konsiderohen si ZR1 - Zonë Aktive Rekreacioni.

Në hartën Nr 11, Zona e Turizmit Aktiv (shkronja D1) nuk ka korrespondencë në Përshkrimet Menaxhuese të Zonës të ZM. Sugjerohet që kjo zonë të konsiderohet si ZPQ - Zonë e Përdorimit të Qëndrueshëm. Përshkrimet Menaxhuese të Zonës korresponduese të aplikohen, sepse aktivitetet e lidhura me industrinë turistike të tilla si zhvillimi i shërbimeve të vizitorit dhe infrastrukturës turistike, hotele dhe restorante dhe strukturat e tjera turistike, janë Aktivitete që kërkojnë Aprovim nga Menaxhimi i PK.

Harta 5: Zonimi i zonës komplekse Karaburun-Rreza e Kanalit-Orikum-Tragajs-Dukat (Harta Nr.11)



Burimi: Plani i Menaxhimit për zonën komplekse të mbrojtur Karaburun-Rreza e Kanalit-Orikum-Tragajs-Dukat

- Ka mungesë përputhshmërie grafike ndërmejt studimeve ekzistuese përsa i takon zonave të propozuara për zhvillim turizmi: - Studimi i Institutit Shtetëror të Urbanistikës i referuar si “Studimi për zonën e Parkut Kombëtar Llogara dhe rrëza e Kanalit” i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit (1996) dhe studimi i MedWestCoast i referuar si “Plani i Menaxhimit për kompleksin e zonës së mbrojtur ‘Karaburun-Rreza e Kanalit-Orikum-Tragjas-Dukat’” (Qershor 2005).
- Ka mungesë përputhshmërie grafike ndërmejt studimeve ekzistuese përsa i takon zonave të propozuara për zhvillim turizmi: - Studimi i Institutit Shtetëror të Urbanistikës i referuar si “Studimi për zonën e Parkut Kombëtar Llogara dhe rrëza e Kanalit” i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit (1996) dhe studimi i MedWestCoast i referuar si “Plani i Menaxhimit për kompleksin e zonës së mbrojtur ‘Karaburun-Rreza e Kanalit-Orikum-Tragjas-Dukat’” (Qershor 2005).

3. Kufizimi i kufijve të bazës ushtarake

Nëse Parku Kombëtar duhet të përdoret për qëllime rekreacioni dhe turizmi, është e rëndësishme që kufijtë e bazës ushtarake të kufizohen në zonën ndërmjet rrugës dhe detit siç tregohet në Harta 5. Siti arkeologjik i Orikumit të hapet për vizita pa qenë i varuar nga baza ushtarake, përndryshe nuk ka kuptim të flitet për menaxhim parku.

Harta 5 më poshtë tregon kufijtë e propozuar për kufizimin e territorit të bazës ushtarake dhe përdorimin e strukturave ushtarake për Administratën e Parkut, Qendër Informacioni dhe Interpretimi për Sitiin Arkeologjik të Orikumit dhe Parkun Kombëtar, dhe Muzeun e Luftës së Ftohtë.

Map 6 Kufijtë e Propozuar për kufizimin e territorit të Bazës Ushtarake.



Aneks 1**Annex 1****1. Lista me njësitë akomoduese për zonën Vlorë - Llogara**

Nr	Emri strukturës akomoduese	Nr. Dhomave	Nr. Shtretërve
1	Hotel Vlora – Vlore	10	20
2	Hotel Greta – Vlore	19	40
3	Hotel Riviera – Vlore	14	26
4	Hotel Alpine – Vlore	14	20
5	Hotel Pavarësia – Vlore	36	72
6	Hotel Bolonja – Vlore	15	35
7	Hotel Vlora Internacional – Vlore	72	100
8	Hotel Alba-Eko – Vlore	12	24
9	Hotel Arpet – Vlore	14	28
10	Hotel Irsa – Vlore	8	24
11	Hotel Tozo – Vlore	12	24
12	Hotel Rossi – Vlore	10	20
13	Hotel Martini – Vlore	20	50
14	Hotel Onorato – Vlore	10	16
15	Hotel Primavera – Vlore	18	36
16	Hotel Ambasador – Vlore	15	45
17	Hotel Delfini – Vlore	18	54
18	Hotel Vlora78 – Vlore	20	60
19	Hotel Bab Pirro – Vlore	21	50
20	Hotel Lungomare – Vlore	10	20
21	Hotel Montecarlo – Vlore	24	58
22	Hotel Ridal – Vlore	11	30
23	Hotel Bojko – Vlore	10	25
24	Hotel Europa – Vlore	14	40
25	Hotel New York – Vlore	84	120
26	Hotel 4 Stinët – Vlore	8	16
27	Hotel Miramare – Vlore	9	18
28	Hotel Konomi – Vlore	20	40
29	Hotel Nacional – Vlore	45	100
30	Hotel Kompleksi Liro – Vlore	12	26
31	Hotel Kalaja – Vlore	9	25
32	Vila Sinani – Vlore	9	27
33	Vila Genti – Vlore	8	32
34	Vila Petriti – Vlore	8	32
35	Hotel Aliko – Vlore	27	65
36	Hotel Nimfa – Radhime	18	54
37	Hotel Agimi – Radhime	16	48
38	Hotel Denta – Radhime	28	56
39	Vila Çapuri – Radhime	17	62
40	Vila Bregdeti – Radhime	14	40
41	Vila Sinaj – Radhime	9	30
42	Vila Tahiraj – Radhime	8	25
43	Hotel Jonufra – Radhime	30	150
44	Hotel Sunny Beach – Radhime	6	18
45	Hotel Fuat Muka – Radhime	10	20
46	Hotel Ibiza – Radhime	10	30
47	Hotel Dion – Radhime	13	30
48	Hotel Gold – Radhime	16	37
49	Hotel Zhironi – Radhime	10	30
50	Hotel Helia – Radhime	11	34
51	Hotel Kompleksi Arvenica – Radhime	4	16
52	Rezidenca Cekodhima – Radhime	26	126
53	Hotel Vellezerit Shehu – Radhime	6	24

54	Hotel Krela – Radhime	10	30
55	Hotel Paradise – Radhime	30	90
56	Hotel Aita – Radhime	12	24
57	Hotel Horizonti - Radhime	20	60
58	Hotel Sirena – Radhime	9	25
59	Rezidenca Olympia – Radhime	20	40
60	Hotel Dea – Radhime	13	44
61	Hotel Edva – Radhime	15	40
62	Hotel Ramosaço – Radhime	10	24
63	Hotel Pashai – Radhime	30	95
64	Hotel Rexhina – Radhime	50	140
65	Hotel Platinium – Radhime	27	81
66	Kompleksi "Te Zagolli" – Tragjas	8	32
67	Hotel Grand Tragjasi – Tragjas	21	60
68	Hotel Argeli – Orikum	27	90
69	Hotel Sori & Bebi – Orikum	16	48
70	Hotel AlbaGert – Orikum	10	33
71	Gabina Plazhi Kleon – Orikum	10	30
72	Fshati Turistik - Llogara	37	100
73	Hotel Alpin – Llogara	17	51
74	Hotel Sofo – Llogara	15	45

2. Lista e Restoranteve të zonës Radhime - Llogara

Bar Restorant "Labëria" - Radhimë
 Taverna "Portokallja" - Radhimë
 Bar Piceri "Freskia" - Orikum
 Bar restorant "La folla" - Orikum
 Bar restorant "46" - Orikum
 Bar restorant "Shtëpia e Peshkut" - Orikum
 Kompleksi "Te Zagolli" – Tragjas
 Bar restorant "Sofra e Vjetër" - Tragjas
 Bar restorant "Panorama" - Llogara

Bibliography

- Day J., Dudley N., Hockings M., Holmes G., Laffoley D., Stolton S. & S. Wells, 2012. *Guidelines for applying the IUCN Protected Area Management Categories to Marine Protected Areas*. Gland, Switzerland: IUCN.
- Dudley, N. (Editor) (2008). *Guidelines for Applying Protected Area Management Categories*. Gland, Switzerland: IUCN.
- Eagles, P., McCool, S. (2002) *Tourism in National Parks and Protected Areas: Planning and Management*. CABI Publishing. Oxon.
- Eagles, P., McCool, S. and Haynes, Ch. (2002). *Sustainable Tourism in Protected Areas: Guidelines for Planning and Management*. IUCN Gland, Switzerland and Cambridge, UK
- IUCN. 1994. *Guidelines for Protected Area Management Categories*. IUCN, Gland, Switzerland.
- IUCN 2003. *Guidelines for Management Planning of Protected Areas*. IUCN, Gland, Switzerland.
- Financing Protected Areas Task Force of the World Commission on Protected Areas (WCPA) of IUCN, in collaboration with the Economics Unit of IUCN (2000). *Financing Protected Areas*. IUCN, Gland, Switzerland and Cambridge, UK.
- Font, X., Cochrane, J., and Tapper, R. (2004) *Tourism for Protected Area Financing: Understanding tourism revenues for effective management plans*, Leeds (UK): Leeds Metropolitan University
<http://mcpa.iwlearn.org> (Improvement of coverage and management of MCPA in Albania)
- Kira Gee, 2007. *Marine Spatial Planning: A Theoretical Overview*. PAP/RAC. Split.
- MedWetCoast, 2004. Management Plan for "Llogora-Rreza e Kanalit-Dukat-Orikum-Tragjas-Radhime-Karaburun Complex Site. Tirana
- Metohu, G., 2010. *Overall guidance (assessment report and ToR) for the development of the Spatial Planning on Liqenas and Proger communes (Prespa area)*. UNDP Albania. Tirana
- Michael. C. Upton, 2006. *A diving survey of the Albanian coast between Saranda and Vlora to asses the potential for diving tourism*. Maltaqua. Malta.
- Ministry of Tourism, Culture, Youth and Sport, Albania (2007) *Tourism Sector Strategy 2007-2013*. UNDP Albania. Tirana.
- PAP/RAC, 2005. *Integrated Coastal Development Study for the Southern Coast of Albania - Oriku Area Inventory and Assessment*.
- SIM Spa, iMed, 2005. *Heritage Assets Mapping - Albania Integrated Coastal Management and clean-up Program*
- Strasdas W., 2002. *The Ecotourism Training Manual for Protected Area Managers*. DSE – ZEL. Germany.
- The Nature Conservancy, 2004. *Ecotourism Development – A Manual for Conservation Planners and Managers, Volume II: The Business of Ecotourism Management and Development UNEP, User's Manual on the CBD Guidelines on biodiversity and Tourism Development*
- Tourism Development International, 2010. *Albania Cultural Marketing Strategy*. UNDP Albania. Tirana.
- WB, 2004. *Management Plan for Dajti National Park*. Tirana
- World Commission on Protected Areas (2002) *Sustainable Tourism in Protected Areas*. Cambridge IUCN
- WTO, 2001. *The British Ecotourism Market*. World Tourism Organization. Madrid;
- WTO, 2001. *The German Ecotourism Market*. World Tourism Organization. Madrid.
- UNWTO (2011b) *Tourism Towards 2030*. Madrid.